



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.56

13 maj

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.249, datë 13.4.2010	Për dhënien në përdorim Komitetit Shtetëror të Minoriteteve të disa mjediseve të ndërtesës së ish-Ministrisë së Transporteve e Telekomunikacioneve.....	2111
Vendim i KM nr.253, datë 13.4.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.52, datë 7.2.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve të komunikimit, ndërmjet AKKP-së dhe institucioneve shtetërore, gjatë procesit të njohjes, kthimit apo kompensimit të pronës”	2111
Vendim i KM nr.254 datë 13.4.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.257, datë 11.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurën e kompensimit fizik, me troje shtetërore, të subjekteve të shpronësuara, në disa raste të veçanta”	2112
Vendim i KM nr.255 datë 13.4.2010	Për procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të akteve të subjekteve të shpronësuara, gjatë procesit të njohjes dhe kthimit apo kompensimit të pronës.....	2113
Vendim i KM nr.256 datë 13.4.2010	Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.....	2116
Vendim i KM nr.257, datë 23.4.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.26, datë 13.1.2010 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve, për vitin 2010, në ministrinë dhe institucionet qendrore”, të ndryshuar....	2119
Vendim i KM nr.258, datë 9.4.2010	Për një shtesë fondesh në buxhetin e vitit 2010, miratuar, përkatësisht, për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	2120

Vendim i KM nr.260, datë 24.2.2010	Për metodikën e llogaritjes së masës së qirasë, kur banesat sociale me qira financohen nga Buxheti i Shtetit ose buxheti i bashkive apo nga kombinimi i të dyjave.....	2121
Vendim i KM nr.262, datë 31.3.2010	Për tarifën e shkollimit për studimet në Shkollën e Magjistratutës.....	2123
Vendim i KM nr.263, datë 7.4.2010	Për disa shtesa në vendimin nr.371, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit”, të ndryshuar.....	2123
Vendim i KM nr.265, datë 21.4.2010	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në fushat e arsimit dhe të shkencës.....	2124
Vendim i KM nr.266, datë 21.4.2010	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.....	2127
Vendim i KM nr.267, datë 21.4.2010	Për përcaktimin e rregullave për bashkërendimin e punës së ALUIZNI-t me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për procedurat e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin.....	2127
Vendim i KM nr.269, datë 21.4.2010	Për blerjen dhe montimin e sistemit të pajisjeve për bllokimin e valëve të telefonisë së lëvizshme në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.....	2128
Vendim i KM nr.271, datë 21.4.2010	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për nënprefektin e Sarandës e administratën e tij dhe për Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile (drejtoria e PMNZSH-së).....	2130
Vendim i KM nr.272, datë 21.4.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qendër Libohovë të qarkut të Gjirokastrës.....	2130
Vendim i KM nr.275, datë 26.4.2010	Për ristrukturimin e shoqërive tregtare me kapital shtetëror “Albpetrol” sh.a., Patos, “Uzina mekanike e naftës Kuçovë” sh.p.k. dhe “Uzina mekanike, Patos”, sh.p.k.....	2131
Vendim i KM nr.281, datë 28.4.2010	Për kompensimin financiar të personave të dëmtuar nga zbatimi i projektit për ndërtimin e shkollës nëntëvjeçare publike në lagjen “Mark Lula”, bashkia Shkodër.....	2132
Udhëzim i MPPT nr.4, datë 23.4.2010	Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr.15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, të ndryshuar.....	2133

Vendim i GJK
nr.17, datë 23.4.2010

Me objekt shfuqizimin: 1) e paragrafit të dytë dhe të tretë të nenit 10 të ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të shtuar me ligjin nr.9701, datë 02.07.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”;

2) e udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.4, datë 21.11.2007 “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre, që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”;

3) e neneve 2 dhe 6 të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 31.01.2007 “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”; si antikushtetuese..... 2134

Kërkesë e MPPT
nr.2552, datë 28.4.2010

Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë arë, truall dhe objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By Pass Plepa–Kavajë Rrogozhinë” 2146

VENDIM
Nr.249, datë 13.4.2010

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM KOMITETIT SHETËTOR TË MINORITETEVE TË DISA
MJEDISEVE TË NDËRTESES SË ISH-MINISTRISË SË TRANSPORTEVE E
TELEKOMUNIKACIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 23.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim Komitetit Shtetëror të Minoriteteve të disa mjediseve, të katit të tretë teknik, të ndërtesës së ish-Ministrisë së Transporteve dhe Telekomunikacioneve, përkatësisht, 4 zyra në këtë kat.

2. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.253, datë 13.4.2010

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 52, DATË 7.2.2007 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË AFATEVE
TË KOMUNIKIMIT, NDËRMJET AKKP-SË DHE INSTITUCIONEVE SHETËTORE, GJATË
PROCESIT TË NJOHJES, KTHIMIT APO KOMPENSIMIT TË PRONËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit 5 të nenit 15 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.52, datë 7.2.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalëve “ ... apo që kanë të dhëna të nevojshme ...”, shtohet “...a dokumentacion ...”.

2. Në pikën 2 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në paragrafin e parë, fjalët “...AKKP-ja dhe zyrat rajonale të saj, kërkojnë...” zëvendësohen me “ ...AKKP-ja kërkon...” dhe fjalët “...informacion apo konfirmim...” zëvendësohen me “...informacion, dokumentacion apo konfirmim...”.

b) Në paragrafin e dytë, fjalët “...Zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP)...” zëvendësohen me “... Zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP)...”.

c) Paragrafi i pestë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“- Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës apo Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit apo organeve në varësi të tyre, përkatësisht për pronat e përmbytura nga hidrocentralet dhe nëse pronarët kanë përfituar sipas ligjit për shpronësimet për interes publik.”.

ç) Paragrafi i njëmbëdhjetë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“- Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.”.

d) Në paragrafin e fundit, pas fjalës “... informacion ...” shtohen fjalët “... ose dokumentacion ...”.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Kërkesa për marrjen e informacionit apo dokumentacionit paraqitet me shkrim e nënshkruhet nga drejtori ose zëvendësdrejtori i AKKP-së, kur ai është i autorizuar.”.

4. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Institucionet e përmendura në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të kthejnë përgjigje me shkrim, të nënshkruar nga titullari ose, në mungesë të tij, nga zëvendësi, pranë AKKP-së, brenda 10 ditëve nga administrimi i kërkesës pranë institucionit të tyre. Në rast të moskthimit të përgjigjes brenda këtij afati, drejtuesi i AKKP-së njofton, me shkrim, Ministrin e Drejtësisë dhe kabinetin e Kryeministrit për institucionet që nuk respektojnë afatet e kthimit të përgjigjeve.”.

5. Në pikën 5, fjalët “... AKKP-në dhe zyrën rajonale në qark, ku ndodhet prona, ...” zëvendësohen me “...AKKP-në, për vendndodhjen e pronës...” dhe fjalët “...brenda 60 ditëve...” zëvendësohen me “... brenda 30 ditëve ...”.

6. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Ngarkohen Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe të gjitha institucionet e përmendura në pikën 2 për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.254, datë 13.4.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.257, DATË 11.4.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E KOMPENSIMIT FIZIK, ME TROJE
SHTETËRORE, TË SUBJEKTEVE TË SHPRONËSUARA, NË DISA RASTE TË VEÇANTA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 29 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.257, datë 11.4.2007 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “a” e pikës 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Kërkesën për kompensim fizik të menjëhershëm, pranë AKKP-së, sipas formularit tip, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. AKKP-ja, nëpërmjet strukturave të saj, pranon, ndjek, plotëson, shqyrton ose heton administrativisht kërkesat e subjekteve të shpronësuara apo përgatit projektaktin a relacionin shoqëruar, të cilat ia kalon për shqyrtim e miratim dhe nxjerrjen e vendimit përkatës drejtorit të Përgjithshëm, sipas ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, duke dokumentuar veprimet që kryen. Këto dokumente përfshihen në dosjen e hapur, me regjistrimin e kërkesës për kompensim, së bashku me dokumentacionin provues, të paraqitur prej tij.

Dokumentimi i veprimeve, në kuptim të këtij vendimi, kryhet nëpërmjet përfshirjes në dosje të çdo shkresë, që i bashkëlidhet praktikës, si dhe nëpërmjet depozitimit të të gjitha procesverbaleve, kujtesave, informacioneve, akteve të vlerësimit apo të ekspertimit, të përgatitura sipas rastit, apo çdo shkresë tjetër për të tretë apo të brendshme, për trajtimin e kësaj kërkesë. Në kuptim të këtij detyrimi, strukturat përkatëse kanë përgjegjësinë ligjore të bëjnë vlerësimin e kërkesës dhe të rrethanave të paraqitura, për çështje të bazueshmërisë së saj në ligj dhe në prova. Vlerësimi është pjesë përbërëse e praktikës dhe nënshkruhet nga grupi i punës me specialistin/ët, jurist dhe hartograf, që shqyrtoi/uan praktikën, dhe përgjegjësinë e sektorit, që e mbikëqyri dhe pranoi atë.”.

3. Fjalja e parë e pikës 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Kur AKKP-ja vëren se kushtet, e përmendura në pikën 2 të këtij vendimi, plotësohen dhe se dokumentet, e përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, janë të vlefshme e të rregullta, ndjek hapat e mëposhtme:”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.255, datë 13.4.2010

PËR PROCEDURAT E MBLEDHJES, PËRPUNIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË AKTEVE TË SUBJEKTEVE TË SHPRONËSUARA, GJATË PROCESIT TË NJOHJES DHE KTHIMIT APO KOMPENSIMIT TË PRONËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 15 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Mbledhja, përpunimi dhe administrimi i akteve të subjekteve të shpronësuara, gjatë procesit të njohjes dhe kthimit apo kompensimit të pronës, të bëhet sipas këtyre procedurave:

I. Mbledhja e akteve

1. Subjekti i shpronësuar depoziton, drejtpërdrejt ose nëpërmjet postës, në sekretarinë e AKKP-së, kërkesën e motivuar për njohjen dhe kthimin apo kompensimin e pronës, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, sipas këtij vendimi, me të cilin provon pretendimet e tij.

2. Kërkesa e subjektit të shpronësuar duhet të jetë sipas formularit tip, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së. Formulari tip nënshkruhet nga subjekti i shpronësuar ose përfaqësuesi i tij me prokurë. Formulari tip përmban një paralajmërim, që ngarkon me përgjegjësi sipas ligjit subjektin kërkuar, në rast të deklarimit të të dhënave të rreme apo depozitimit të dokumentacionit të falsifikuar.

3. Dokumentacioni shoqëruar, që vërteton pronësinë e subjektit të shpronësuar, përbëhet nga:

- a) dokumentacioni ligjor;
- b) dokumentacioni hartografik.

Në çdo rast që subjekti depoziton kërkesë të re, sipas një vendimi gjyqësor për rivendosje në afat, pjesë e dokumentacionit shoqëruar është edhe vendimi i gjykatës për rivendosjen në afat.

4. Dokumentacioni ligjor përbëhet, sipas rastit, nga:

a) vërtetimi i pronësisë, shoqëruar me kopje të njehsuar të fletës përkatëse të regjistrit hipotekor, të lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për efekt të kthimit dhe kompensimit të pronave;

b) dokumenti kadastral, shoqëruar me kopje të njehsuar të fletës përkatëse të regjistrit kadastral, pranë zyrave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës, në këshillin e qarkut;

c) vendimi gjyqësor i formës së prerë, së bashku me hartën e pasurisë, të vulosura nga gjykata, si dhe aktekspertimi, në rast se gjatë gjykimit të çështjes në gjykatë është kryer një i tillë;

ç) dokumenti që vërteton heqjen ose marrjen e së drejtës së pronësisë nga shteti subjektit të shpronësuar, sipas akteve ligjore e nënligjore, vendimeve penale të gjykatave ose në çdo mënyrë tjetër të padrejtë që nga data 29.11.1944, apo dokumenti për pasuritë e paluajtshme të shtetasve shqiptarë, të krijuara përpara datës 7 prill 1939, të cilat janë sekuestruar sipas nenit 14 të ligjit nr.37, datë 13.1.1945 “Ligja e tatimit të jashtëzakonshëm për fitimet e luftës”;

d) vendimet e mëparshme të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, vendimet e Komisionit/Komitetit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të cilat janë marrë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.9583, datë 17.7.2006 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar”;

dh) dokumenti i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (kur dokumente si akttranskripti, aktpjesëtim pasurie, aktshitjeje apo fletë regjistri kadastral, dokumente që vërtetojnë shpronësimin, konfiskimin apo shtetëzimin e pronës janë të depozituara në të), si dhe çdo dokument tjetër i lëshuar nga institucionet shtetërore, me vlerë provuese në hetimin administrativ të çështjes në shqyrtim;

e) dokumenti i lëshuar nga arkivi hipotekor (pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme);

ë) çdo dokument tjetër ligjor, i nevojshëm për zgjidhjen e drejtë të çështjes.

5. Dokumentacioni hartografik për pozicionin gjeografik të pronës, i cili përbëhet, sipas rastit, nga:

a) dokumentacioni hartografik i mëparshëm, që i takon kohës nga fitimi i së drejtës së pronësisë deri në marrjen e padrejtë të pronës nga shteti. Ky dokumentacion përmban çdo të dhënë topografike dhe hartografike, të konfirmuar nga institucioni shtetëror që e administron atë dhe mund të sigurohet nga:

i) ministria përgjegjëse për punët publike, e cila ka në varësi Arkivin Qendror Teknik dhe degët e tij në rrethe, ose nga Instituti Gjeografik Ushtarak;

ii) departamenti i shërbimit të tokës dhe ujit (ish-Instituti i Studimit të Tokave) në QTTB, Fushë-Krujë;

iii) Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;

iv) Drejtoria e Shërbimit Pyjor (arkivi i kadastrës pyjore);

v) bashkia/qarku (arkivi hartografik i urbanistikës);

vi) këshilli i qarkut (zyra e administrimit dhe mbrojtjes së tokës);

vii) çdo institucion tjetër shtetëror që disponon të dhëna për vendndodhjen e pronave.

b) dokumentacioni hartografik aktual, i cili përmban çdo të dhënë topografike dhe hartografike të pronës së pretenduar në pasqyruar në hartën aktuale dhe të konfirmuar nga institucioni që e administron atë. Harta mund të sigurohet në një nga institucionet e poshtëshënuara:

i) Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të gjitha zonat urbane dhe për zonat rurale, ku është bërë regjistrimi;

ii) Drejtoria e Shërbimit Pyjor, për pyjet e kullotat dhe tokat e tjera jobujqësore;

iii) këshilli i qarkut (zyra e administrimit dhe mbrojtjes së tokës), për tokat bujqësore të paregjistruara, dhe tokat e tjera jobujqësore;

iv) njësitë e legalizimit, pranë organeve të qeverisjes vendore apo Agjencia e Legalizimeve dhe Urbanizimit të Zonave Informale (ALUIZNI), të krijuara sipas ligjit nr.9482, datë 16.2.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

6. Subjekti i shpronësuar paraqet, pranë AKKP-së, kërkesën e motivuar për kompensimin e pronës, shoqëruar me dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) kërkesën, e nënshkruar, të subjektit të shpronësuar apo të përfaqësuesit të tij me prokurë, sipas dhe në zbatim të formularit tip, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së, në të cilën përcaktohet edhe njëra nga format e kërkuara të kompensimit, të parashikuara në nenin 11 të ligjit;

b) vendimin e AKKP-së apo të ish-komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave për pasurinë e paluajtshme, të njohur për t’u kompensuar;

c) deklaratën personale për heqje dorë nga e drejta e parablerjes, sipas formularit tip, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së;

ç) çdo dokument ligjor që provon lidhjen e ligjshme të kërkuarit me subjektin e shpronësuar.

II. Administrimi i akteve

7. Në rastet kur AKKP-ja konstaton mungesë në dokumentacion, subjektit të shpronësuar i kërkohet plotësimi i dosjes përkatëse, brenda 30 ditëve nga çasti i marrjes së njoftimit për plotësim dokumentacioni. Plotësimet mund të bëhen për të gjitha dosjet e paraqitura për shqyrtim në ish-zyrat rajonale të AKKP-së në qark, para datës 31.12.2008, ose edhe për dosjet e subjekteve pas kësaj date, të cilat, në bazë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, janë rivendosur në afat.

8. Çdo subjekt i shpronësuar ka të drejtë të pajiset, nga sekretaria e AKKP-së, me vërtetimin përkatës për numrin e protokollit të dosjes së regjistruar, që tregon edhe datën e dorëzimit të kërkesës dhe dokumenteve të tij.

9. Kërkesat e subjekteve të shpronësuar, të cilat depozitohen nëpërmjet shërbimit postar dhe kanë mangësi në dokumentacionin shoqëruar, gjë që e bën të pamundur vlerësimin e tyre, do t’i kthehen kërkuarit në adresën e dhënë, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit në mënyrë të hollësishme,

sipas dispozitave të këtij vendimi. Kërkesa, së cilës i mungon adresa e saktë postare, vlerësohet jo e mirëqenë dhe riaktivizohet vetëm me interesimin e kërkuarit pranë zyrave të AKKP-së. Në çastin e konstatimit, nga struktura përkatëse e AKKP-së, bëhet shpallja publike në mjediset e AKKP-së dhe në njësitë e qeverisjes vendore, ku ndodhet prona, objekt pretendimi. Kërkesa e subjektit të interesuar pranohet brenda një afati 3-mujor nga data e konstatimit, në të kundërt kërkesa e subjektit nuk pranohet, me vendim të drejtorit të Përgjithshëm të AKKP.

10. AKKP-ja pranon dhe administron kërkesat e subjekteve të shpronësuara kundrejt tarifave të përcaktuara, me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Financave.

III. Përpunimi i akteve

11. AKKP-ja, në varësi të objektit të kërkesës së subjektit të shpronësuar, bashkërendon punën me institucione të treta, duke kërkuar dokumente të nevojshme për vërtetimin e gjendjes juridike apo fizike të pronës, si dhe konfirmimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të depozituar nga subjekti. Ky dokumentacion, sipas rastit, mund të kërkohej nga një ose disa prej institucioneve të mëposhtme:

a) Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP), për gjendjen juridike të pronës;

b) njësitë e qeverisjes vendore, për pronat që i shërbejnë një interesi publik dhe për të cilat bëhet propozimi për tjetërsim;

c) bashkia (drejtoria e përgjithshme e urbanistikës), komuna, këshilli i qarkut (drejtoria e urbanistikës apo njësitë e legalizimit për konfirmimin e gjendjes së trojeve dhe të ndërtesave);

ç) Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës apo organet në varësi të saj, për pronat për të cilat ka humbur interesi publik dhe janë në pritje të procesit të privatizimit, për pronat e përmbytura nga hidrocentralet dhe nëse për këto prona ka pasur përfitim sipas legjislacionit për shpronësimet për interes publik;

d) Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;

dh) Agjencia e Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave Informale;

e) Enti Kombëtar i Banesave;

ë) çdo institucion tjetër shtetëror, i cili ka në administrim pronën apo që mund të japë informacion për të.

12. Të gjitha kërkesat për njohje dhe kthim të pronës, të paraqitura në zyrat e AKKP-së, shqyrtohen sipas rendit kronologjik të paraqitjes së tyre. Mënyra e trajtimit, shqyrtimit dhe e dhënies së vendimit për kërkesat apo ankesat e subjekteve të shpronësuara, bëhet në përputhje me ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

13. AKKP-ja, pas shqyrtimit të kërkesës dhe marrjes së vendimit, pajis subjektet e shpronësuara me dokumentin përkatës për njohjen, masën dhe mënyrën e kthimit ose të kompensimit të pronës. Në rastin kur AKKP-ja nuk e pranon/rrëzon kërkesën/ankesën e subjektit, i jep subjektit të shpronësuar një kopje të vendimit të mospranimit/rrëzimit.

14. Ngarkohet Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

15. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.747, datë 9.11.2006 “Për procedurat e mbledhjes, të përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuara gjatë procesit të njohjes, kthimit apo kompensimit të pronës”, shfuqizohet. Kërkesat e paraqitura pranë ish-zyrave rajonale të AKKP-së apo ankesat e paraqitura në AKKP, bazuar në vendimin nr.747, datë 9.11.2006 të Këshillit të Ministrave, për të cilat ende nuk është dhënë vendim, vazhdojnë të shqyrtohen nga AKKP-ja, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.256, datë 13.4.2010

**PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË SË KTHIMIT
DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 15 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Republikën e Shqipërisë, më poshtë e quajtur AKKP-ja, është person juridik publik, me qendër në Tiranë, në varësi të Ministrit të Drejtësisë.

2. AKKP-ja përmbush objektivat, kryen detyrat dhe ushtron përgjegjësitë në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.

3. AKKP-ja, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, është e hapur për publikun dhe në shërbim të subjekteve të shpronësuara apo të trashëgimtarëve të tyre, gjatë të gjithë orarit zyrtar të punës. Çdo kufizim, brenda orarit zyrtar, për aplikim, plotësim dokumentacioni, takim, këshillim, me punonjësit e AKKP-së, përcaktohet me urdhër të brendshëm të drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie.

4. Organika dhe struktura e AKKP-së përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”.

5. AKKP-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm dhe 2 (dy) zëvendës drejtorë të Përgjithshëm.

6. Drejtori i Përgjithshëm, përveç detyrave dhe përgjegjësiave të parashikuara në ligj, ushtron dhe këto përgjegjësi:

a) Drejton AKKP-në dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët.

b) Autorizon kryerjen e veprimeve të caktuara nga zyrtarë të tjerë të AKKP-së për përmbushjen e detyrave të saj.

c) Raporton, informon dhe i relaton për veprimtarinë e AKKP-së Ministrit të Drejtësisë, si dhe zbaton urdhrat dhe udhëzimet e tij.

ç) Raporton në institucionet kushtetuese, sipas këtij vendimi.

7. Dy zëvendës drejtorët e Përgjithshëm drejtojnë, përkatësisht, strukturat e mëposhtme:

a) Drejtorinë e Kthimit të Pronave, përgjegjëse për:

i) shqyrtimin në kohë, dhe ndjekjen e zgjidhjen, sipas ligjit, të kërkesave të subjekteve të shpronësuara;

ii) përditësimin e të dhënave në regjistër për çështjet e shqyrtuara (njohje, kthim apo kompensim pronash);

iii) regjistrimin pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme të vendimeve, ku disponohet, në favor të subjektit të shpronësuar, e drejta e pronësisë për pasuri të paluajtshme apo të drejta reale të lidhura me to;

iv) çdo detyrë tjetër, të caktuar nga drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së.

b) Drejtorinë e Kompensimit të Pronave, përgjegjëse për:

i) evidentimin e subjekteve dhe përgatitjen e të dhënave të regjistrimit për subjektet e shpronësuara, të cilëve iu është njohur e drejta për kompensim dhe që ende nuk e kanë përfituar atë;

ii) përlllogaritjen e faturës financiare;

iii) administrimin dhe shpërndarjen, sipas ligjit, të fondit të kompensimit, të vënë në dispozicion;

iv) shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për tjetërsim të sipërfaqeve, pronë shtetërore, për llogari të fondit të kompensimit financiar;

v) çdo detyrë tjetër, të caktuar nga drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së.

8. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, ndërsa 2 zëvendës drejtorët e Përgjithshëm emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra nga Kryeministri, me propozimin e ministrit të Drejtësisë. Drejtori i Përgjithshëm dhe 2 (dy) zëvendës drejtorët e Përgjithshëm propozohen nga radhët e personave të aftë profesionalisht, me përvojë në drejtim dhe me integritet të lartë personal.

Kryeministri, në urdhrin e emërimit, përcakton zëvendës drejtorin përgjegjës, i cili, në mungesë të drejtorit të Përgjithshëm, ka të drejtën të ushtrojë detyrat e përgjegjësitë, për përfaqësimin e AKKP-së, për çështjet e përcaktuara në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.

9. Kur vendi mbetet vakant për më shumë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së, në zbatim të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, ushtrohen, drejtpërdrejt, në përputhje me nenin 34 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nga zëvendës drejtori i Përgjithshëm, që mban këtë tagër, sipas përcaktimit të bërë në urdhrin e emërimit të tij në detyrë. Në çdo rast, AKKP-ja evidenton në regjistrat e saj, në mënyrë të saktë, periudhën e zëvendësimit dhe e bën publike për çdo të interesuar edhe në faqen e internetit të Agjencisë. Ky informacion përditësohet çdo muaj.

Për çdo detyrë a përgjegjësi tjetër, zëvendësimi ose delegimi kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

10. Dy zëvendës drejtorët e Përgjithshëm i raportojnë me shkrim, një herë në muaj, drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së. Raporti përmban të dhëna:

a) të përgjithshme për ecurinë e procesit të njohjes, të kthimit e të kompensimit të pronave dhe për mbarëvajtjen e këtij procesi, përfshirë të dhëna për masën e sipërfaqes së njohur, të kthyer dhe atë të njohur për kompensim, dhe, sipas rastit, edhe për përcaktimin e zërit kadastral të saj, si dhe për vlerën e kompensuar;

b) për numrin e kërkesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuara për realizimin e së drejtës së njohur për kompensim, vlerën dhe llojin e pasurisë, objekt kërkimi;

c) për numrin e kërkesave të shqyrtuara e për raportet e kthimit e të kompensimit, indeksin e saktë të çështjeve të pranuar apo të rrëzuara;

ç) për nivelin e bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore dhe për problematikat e hasura;

d) për indeksin e rasteve të ankimit gjyqësor dhe për ecurinë e çështjeve në gjykatë;

dh) për indeksin e vendimeve të njohura për kompensim dhe të atyre të njohura me të drejtë parablerjeje, në përputhje me regjistrin e subjekteve, që u është njohur e drejta për t'u kompensuar ose e drejta e parablerjes;

e) për informatizimin dhe përditësimin e regjistrit dixhital të arkivit të AKKP-së;

ë) për përditësimin e hartës së vlerës dhe çdo lloj projekti tjetër, që ka të bëjë me dixhitalizimin e të dhënave të pronësisë;

f) të tjera, që mund të kërkohen nga drejtori i Përgjithshëm.

Raporti për drejtorin e Përgjithshëm duhet të përmbajë edhe informacion për mënyrën e zbatimit të politikës, performancën e personelit të punësuar, zbatimin e ndjekjen e buxhetit, zbatimin e detyrave e të përgjegjësisve, të lëna nga drejtori i Përgjithshëm, raportet e Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit, në Kryeministri, apo raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

11. AKKP-ja, nëpërmjet strukturave të saj, pranon, ndjek, plotëson, shqyrton apo heton administrativisht, kërkesat e subjekteve të shpronësuara dhe i ushtron funksionet e veta në përputhje me ligjet nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, e nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me ligjet e aktet nënligjore në fuqi, si dhe me aktet e brendshme të drejtorit të Përgjithshëm.

12. Të gjithë punonjësit e AKKP-së, që, sipas detyrës funksionale, pranojnë, prapunojnë, plotësojnë, shqyrtojnë, hetojnë, mbikëqyrin kërkesat e subjekteve të shpronësuara apo përgatisin vlerësimin ligjor, relacionin shoqëruar, a projektaktin, që kalon për shqyrtim e miratim e për nxjerrjen e vendimit nga drejtori i Përgjithshëm, sipas ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, kanë përgjegjësinë e vlerësimit ligjor të çështjes dhe të propozimit në funksion të zgjidhjes së drejtë të saj, si dhe të administrimit, të pasqyrimin e të dokumentimit të çdo të dhëne e veprimi teknik apo procedural, të kryer në lidhje me dosjen, objekt shqyrtimi.

Evidentimi i të gjitha veprimeve procedurale kryhet nëpërmjet përfshirjes në dosje të çdo shkresë, që i bashkëlidhet praktikës, si dhe nëpërmjet depozitimit të të gjitha procesverbaleve, kujtesave, informacioneve, akteve të vlerësimit teknik a ekspertimit, vlerësimeve ligjore të përgatitura, sipas rastit, apo çdo shkresë tjetër të brendshme apo për të tretët, lidhur me trajtimin e kërkesës.

Në kuptim të këtij detyrimi, sektori i pranimit të kërkesave/ankesave dhe ai i vlerësimit kanë përgjegjësinë ligjore të vlerësojnë ligjërisht e hartografikisht kërkesat dhe dokumentet e paraqitura, për

çështje të bazueshmërisë së saj në ligj dhe në prova, brenda afatit procedural, të përcaktuar në ligj. Vlerësimi ligjor dhe hartografik i çështjes është pjesë përbërëse e praktikës dhe nënshkruhet nga grupi i punës me specialistin/ët, juristë dhe hartografë, që shqyrtoi/uan praktikën, dhe përgjegjësin e sektorit, që e mbikëqyri dhe pranoi atë.

Ministri i Drejtësisë miraton me urdhër modelet e vendimeve të AKKP-së për pranimin e kërkesave/ankesave për njohjen, kthimin apo kompensimin, si dhe për mospranimin/rrëzimin e kërkesave/ankesave.

13. Drejtori i Përgjithshëm i raporton, me shkrim, periodikisht, çdo tre muaj, Kryeministrin dhe Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financën, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Raporti përmban të dhëna:

a) të përgjithshme për ecurinë e procesit të njohjes, të kthimit e të kompensimit të pronave dhe për mbarëvajtjen e tij, si dhe për detyrimin për të raportuar për sipërfaqen dhe vlerën në lekë;

b) për numrin e kërkesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuara, të ndara sipas qarkut dhe në shkallë vendi, si dhe për llojin e pasurisë;

c) për numrin e kërkesave të shqyrtuara, për raportet e kthimit e të kompensimit, indeksin e saktë të çështjeve të pranuar a të rrëzuara në AKKP, si dhe për numrin e çështjeve të ndjekura e të ankimuara në gjykatë;

ç) për numrin e kompensimeve të kryera nga AKKP-ja dhe vlerën e tyre;

d) për numrin e vendimeve të marra nga drejtori i Përgjithshëm, si dhe indeksin e çështjeve, për të cilat është vendosur pranimi i ankimit, rrëzimi apo zgjidhja në themel;

dh) për nivelin e bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore;

e) për indeksin e rasteve të ankimit gjyqësor;

ë) për politikën e ndjekur nga Agjencia dhe për masat e marra për çështje të kontrollit të ligjshmërisë, të luftës kundër korrupsionit, konfliktit të interesit, mitmarrjes apo favorizimeve të tjera, të paligjshme;

f) për trajtimin e denoncimeve nga qytetarët;

g) për çdo çështje tjetër, për të cilën kërkohet informacion apo që, sipas vlerësimit të drejtorit të Përgjithshëm, duhet të vihet në dijeni Kryeministri dhe/apo komisioni përkatës i Kuvendit.

Të dhënat e përcaktuara nga shkronja “a” deri në shkronjën “g” dhe të dhënat e tjera, që kanë lidhje me procesin e njohjes, të kthimit e të kompensimit të pronave, për subjektet e shpronësuara, bëhen publike në faqen elektronike të Agjencisë, brenda 2 (dy) javëve nga data e dorëzimit të raportit.

14. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së ndjek dhe vë në dijeni, çdo muaj, Ministrin e Drejtësisë, për ecurinë e vendimmarrjes ndaj kërkesave të subjekteve të shpronësuara, për çështje të përfaqësimit të interesave ligjorë të shtetit në gjykatë, gjatë zgjidhjes dhe shqyrtimit të konflikteve, dhe për çdo çështje, sa herë që i kërkohet ose çmohet e domosdoshme nga drejtori i Përgjithshëm.

15. Drejtuesit e ish-zyrave rajonale në qarqe dorëzojnë pranë AKKP-së, në përputhje me nenin 20 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dokumentacionin përkatës për logjistikën, mjetet e punës dhe të gjithë fondin e inventarizuar arkivor në ngarkim të ish-drejtuesve rajonalë dhe arkivistëve përgjegjës. Inventarizimi, dorëzimi dhe ruajtja e administrimi i dokumentacionit në AKKP dhe në zyrat rajonale kryhen në përputhje me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”.

16. Personeli i AKKP-së duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 12 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, dhe kërkesat e veçanta, të përcaktuara nga drejtori i Përgjithshëm. AKKP-ja rekruton personel, specialistë me përvojë dhe integritet të lartë moral, të diplomuar në degët drejtësi, urbanistikë, arkitekturë, inxhinieri, specialistë për vlerësim pasurish të paluajtshme, ekonomistë, topografë dhe personel ndihmës. Marrëdhëniet e punës rregullohen me ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

17. AKKP-ja financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga donacionet e ndryshme. Drejtori i Përgjithshëm bashkërendon punën në vijim me donatorët dhe organizatat ndërkombëtare për asistencën teknike në proces dhe informon Ministrin e Drejtësisë për donacionet.

18. Ngarkohet prefekti i çdo qarku të mbikëqyrë transferimin e arkivit, të logjistikës dhe të mjeteve të punës së zyrave rajonale menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij akti dhe njofton me shkrim Kryeministrin për ecurinë e procesit.

Transferimi të kryhet me procesverbal dhe me inventar të hollësishëm të çdo dokumenti të mëparshëm, ekzistues në dosje, për çdo praktikë të depozituar nga subjektet e shpronësuara.

19. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.566, datë 23.8.2006 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, dhe nr.51, datë 7.2.2007 “Për miratimin e modeleve të vendimeve që lëshohen nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe zyrate rajonale të saj, për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës”, shfuqizohen.

Kërkesat e paraqitura pranë ish-zyrave rajonale të AKKP-së apo ankimet e paraqitura në AKKP, për të cilat ende nuk është dhënë vendim, vazhdojnë të shqyrtohen nga AKKP-ja, sipas rregullave të këtij vendimi.

20. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.257, datë 23.4.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.26, DATË 13.1.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE, PËR VITIN 2010, NË
MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr.26, datë 13.1.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve buxhetorë, për vitin 2010, për ministrinë dhe institucionet qendrore, është 89 186 veta, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Ngarkohen të gjitha ministrinë dhe institucionet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Gr.	Institucionet buxhetore	Viti 2010
3	Kryeministria	128
4	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	785
5	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	2 163
6	Ministria Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	1 330
10	Ministria e Financave	3 130
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	39 030
12	Ministria Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1 089
13	Ministria e Shëndetësisë	3 444
14	Ministria e Drejtësisë	4 972
15	Aparati i Ministrisë së Punëve të Jashtme	187
	Përfaqësitë diplomatike	428
16	Ministria e Brendshme	13 382
17	Ministria e Mbrojtjes	11 735
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	940
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	155

22	Akademia e Shkencave	29
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale, Shanseve të Barabarta	1 419
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	1 360
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	82
50	Instituti i Statistikës	215
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	9
59	Instituti i Rehabilitimit të të Përndjekurve Politikë	24
78	Ministria e Integritetit	74
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6
87	Institucione të tjera qeveritare, nga të cilat:	148
	- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	37
	- Agjencia e Prokurimit Publik	18
	- Komitetit Shtetëror i Minoriteteve	8
	- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	35
	- Agjencia Kombëtare e Teknologjisë dhe Inovacionit	15
	- Agjencia Kombëtare e Certifikimit Elektronik	9
	- Agjencia Kombëtare Bërthamore	8
	- Komisioni i Prokurimit Publik	18
88	Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile	12
	Total	86 276
	Total për institucionet e pavarura	2 910
	Totali gjithsej	89 186

VENDIM
Nr.258, datë 9.4.2010

**PËR NJË SHITESË FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËRKATËSISHT,
PËR MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE DHE MINISTRINË E
PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, zëri “Projekte kulturore”, t’i shtohet fondi 8 400 000 (tetë milionë e katërqind mijë) lekë, për organizimin e veprimtarive kulturore, në kuadër të festës së 1 Majit, Ditës Ndërkombëtare të Punëtorëve.

2. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi 19 800 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë, për realizimin, prodhimin dhe transmetimin e spotit, publicitar dhe dokumentar, si dhe për përgatitjen e materialeve dekorative, e të tjera, në kuadër të festës së 1 Majit, Ditës Ndërkombëtare të Punëtorëve.

3. Këto fonde të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.260, datë 24.2.2010

PËR METODIKËN E LLOGARITJES SË MASËS SË QIRASË, KUR BANESAT SOCIALE ME QIRA FINANCOHEN NGA BUXHETI I SHTETIT OSE BUXHETI I BASHKIVË APO NGA KOMBINIMI I TË DYJAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 11 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për llogaritjen e masës së qirasë, për banesat sociale me qira, që sigurohen nëpërmjet ndërtimit të banesave të reja, në koston e ndërtimit përfshihen të gjitha shpenzimet e kryera për ndërtimin e ndërtesës së banimit, si:

- a) vlera e investimit për ndërtimin e ndërtesës;
- b) vlera e plotë e projektit teknik;
- c) kostoja e blerjes së tokës, kur ajo nuk është pronë e bashkisë;
- ç) vlera e investimit për lirimin e sheshit të ndërtimit;
- d) vlera e mbikëqyrjes së punimeve;
- dh) taksat, tatimet dhe tarifat e aplikueshme gjatë ndërtimit të objektit;
- e) kostot e menaxhimit të zbatimit të projektit;
- ë) kostot për kolaudimin dhe tarifën e regjistrimit të pronës në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP).

2. Në koston e ndërtimit nuk përfshihen:

- a) vlera e truallit, kur investimi është bërë në truall, pronë e bashkisë;
- b) investimet për lidhjen me rrjetin kryesor të infrastrukturës, si ujësjellës, kanalizime, telefoni, energji elektrike;
- c) vlera e investimit për katet e para, kur këto nuk janë të parashikuara për banesa sociale;
- ç) taksat, tatimet dhe tarifat vendore, të cilat, për projektin në fjalë, mund të jenë konsideruar, si kontribut i bashkisë.

3. Për banesat sociale, që blihen në treg, masa e qirasë llogaritet në bazë të vlerës së blerjes së banesës në treg. Në këtë vlerë përfshihen:

- a) vlera e investimit për blerjen e banesës;
- b) shpenzimet për riparime;
- c) shpenzimet administrative të kryera për blerjen e banesës;
- ç) kostoja për regjistrimin e pronës në ZRPP;
- d) taksat dhe tarifat e aplikueshme;
- dh) çdo shpenzim tjetër i paparashikuar.

4. Shumatorja e të dhënave, sipas pikave 1 e 2 të këtij vendimi, pjesëtuar në mënyrë proporcionale për çdo njësi banimi, sipas përqindjes që zë sipërfaqja e çdo apartamenti ndaj sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit të objektit të banimit, përdoret për llogaritjen e nivelit maksimal të qirasë, sipas formulës, dhënë në aneksin A, që i bashkëlidhet ligjit nr.9232, datë 13.5.2004, të ndryshuar.

5. Për llogaritjen e nivelit maksimal të qirasë, sipas pikave 4 e 6 të këtij vendimi, jepet shembulli, si më poshtë vijon:

- a) Kostoja e përgjithshme e ndërtimit sipas pikës 1 të këtij vendimi,
 $K = 95,155,001.00$ lekë;
- b) Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit: $S = 3,370 \text{ m}^2$;
- c) Sipërfaqja e apartamentit tip 1: $S_1 = 55.25 \text{ m}^2$;
- ç) Përqindja që zë sipërfaqja e apartamentit ndaj totalit $P = 55.25/3,370 = 1.63\%$;
- d) Kostoja e apartamentit tip 1: $K_{S1} = a \times d = 95,155,001 \times 1.63\% = 1,522,480$ lekë;
- dh) Qiraja mujore maksimale: $Q = \frac{K_{S1} \times 0.04}{12} = \text{Lek } 5,170.00$

6. E njëjta procedurë sipas pikës 5 të këtij vendimi, ndiqet edhe për llogaritjen e qirasë për objekte të dala jashtë funksionit, të transformuara në banesa sociale.

Në këtë rast, llogaritja e kostos bëhet në bazë të:

- a) vlerës kontabël të objektit;
- b) kostove të investimit për transformimin në banesë sociale;
- c) tarifës për regjistrimin e pasurisë.

7. Në rastin kur në katet e para të objektit të ndërtuar janë parashikuar mjedise shërbimi, qiraja e tyre, në varësi të destinacionit, përcaktohet sipas nivelit të qirave të objekteve të ngjashme në treg.

8. Niveli minimal i qirasë llogaritet sa 50 për qind e nivelit maksimal të qirasë. Për familjet sipas shkronjave “d” e “f” të nenit 5 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004, të ndryshuar, niveli minimal i qirasë llogaritet sa 25 për qind e qirasë maksimale.

9. Për çdo objekt të ri që ndërtohet apo blihet në treg, masa e qirasë llogaritet vetëm një herë dhe miratohet me vendim të këshillit bashkiak. Ky nivel qiraje përdoret deri në fund të muajit janar të vitit pasardhës. Çdo vit niveli i qirasë së miratuar nga këshilli bashkiak shumëzohet me indeksin e çmimeve të konsumit dhe miratohet nga këshilli bashkiak. Kur në objekt janë kryer investime për riparime apo rinesime, që nuk bëjnë pjesë në mirëmbajtjen rutinë, kostot e investimit i shtohen kostos aktuale të banesës. Me kosto aktuale, në kuptim të këtij vendimi, nënkuptohet kostoja fillestare e shumëzuar çdo vit me indeksin e çmimeve të konsumit.

10. Për çdo njësi banimi, zyrat përkatëse në bashki mbajnë evidenca të plota, sipas formularit tip, me shpjegimet përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

11. Të ardhurat, që mblihen nga qiratë, derdhen në llogari të veçantë. Këshilli bashkiak vendos për të çelur një llogari të veçantë në një bankë të nivelit të dytë ose në degën e thesarit, duke përcaktuar, për çdo rast, përgjegjësitë e entit menaxhues dhe të strukturave përkatëse në bashki, për mënyrën e përdorimit, të raportimit e të kontrollit të përdorimit të këtyre të ardhurave.

12. Ngarkohen organet e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Formulari tip

BASHKIA								
Data				Sipërfaqja totale e ndërtimit (vetëm për njësitë e banimit)				
Nr. i pronës				Sipërfaqja totale e banimit (m ²)				
Enti menaxhues				Kostoja totale e ndërtimit (lek)				
Personi përgjegjës i bashkisë				Kosto për njësi për llogaritjen e qirasë lek/m ²				
Adresa e objektit								
Përcaktimi i qirasë		Viti		Kodi i financës				
Nr.	Tipi i apartamentit (G,1+1, 2+1,3+1)	Sipërfaqja e ndërtimit që i korrespondon apartamentit (m ²)	Madhësia e familjes (të rritur + fëmijë)	Treguesi P	Qiraja mujore maksimale (lek)	Të ardhurat neto të familjes (lek)	Qiraja mujore aktuale (lek)	Masa mujore e subvencionit
1	2	3	4	5	6	7	8	9

Shpjegime të formularit tip:

- a) “Data” vendoset data e miratimit nga këshilli bashkiak.
- b) “Enti menaxhues” është subjekti i ngarkuar ose kontraktuar nga bashkia për administrimin e banesave sociale me qira.
- c) “Personi përgjegjës i bashkisë” është personi i ngarkuar nga bashkia për të ndjekur çështjet e administrimit dhe mirëmbajtjes së pronës.
- d) “Kodi i financës” tregon formën e përzgjedhur nga bashkia për mbajtjen e llogarive ku derdhen të ardhurat nga qiratë e objektit.
- e) “Numri i apartamentit” është numri me të cilin është regjistruar njësia specifike e banimit në regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe që reflektohet në adresën e apartamentit.

- f) "Sipërfaqja e ndërtimit" që i korrespondon apartamentit përfshin edhe sipërfaqet e pjesëve të përbashkëta, si mure, shkallë, korridore etj.
- g) "Treguesi P" llogaritet sipas shkronjës "d" të pikës 5 të këtij vendimi.
- h) "Qiraja mujore maksimale" përcaktohet sipas pikave 3 e 5 të këtij vendimi.
- i) "Qiraja mujore aktuale" është masa e qirasë që paguan familja me të ardhura të ulëta, llogaritur sipas të dhënave të kolonës 7.
- j) "Masa mujore e subvencionit" është diferenca midis kolonave 6 dhe 8.

VENDIM
Nr.262, datë 31.3.2010

PËR TARIFËN E SHKOLLIMIT PËR STUDIMET NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.2, e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Drejtësisë dhe të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifa e shkollimit për studimet në Shkollën e Magjistraturës të jetë 100 000 (njëqind mijë) lekë.
2. Studenti i nënshtrohet tarifës së shkollimit vetëm një herë, në fillim të ciklit 3-vjeçar të studimeve.
3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Shkolla e Magjistraturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.263, datë 7.4.2010

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.371, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrisë të Brendshëm dhe të Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.371, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat e mëposhtme:
 - a) Në fund të pikës 1 të shtohen emërtesat "Komisioni i Prokurimit Publik" dhe "Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile".
 - b) Në kategorinë II-b të lidhjes nr.1, të përmendur në pikën 2, të shtohet emërtesa "Anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik".
 - c) Pas pikës 2/2 të shtohet pika 2/3, me këtë përmbajtje:

“2/3. Kryetari dhe anëtarët e bordit mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile përfitojnë, për çdo mbledhje, përkatësisht, kryetari një shpërblim, në masën 7 000 (shtatë mijë) lekë, ndërsa anëtarët një shpërblim në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, me kushtin e pjesëmarrjes në mbledhje dhe jo më shumë se një herë në muaj.”.

ç) Pas pikës 8/1 të shtohet pika 8/2, me këtë përmbajtje:

“8/2. Kryetari i Komisionit të Prokurimit Publik përfiton një shtesë për kushte pune, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse, ndërsa zëvendëskryetari, anëtarët dhe nëpunësit në drejtoritë apo sektorët teknikë të këtij Komisioni, përfitojnë një shtesë, për kushte pune, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj, mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse.”.

2. Pagat e punonjësve të tjerë mbështetës të Komisionit të Prokurimit Publik dhe të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile të përcaktohen sipas vendimit për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.

3. Efektet financiare, për vitin 2010, të përballohen nga fondet e planifikuara për Komisionin e Prokurimit Publik dhe për Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data e emërimit të nëpunësve në detyrë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.265, datë 21.4.2010

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR
BASHKËPUNIMIN NË FUSHAT E ARSIMIT DHE TË SHKENCËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në fushat e arsimit dhe të shkencës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E ARSIMIT
DHE SHKENCËS

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, më poshtë të quajtura palë, me besimin se bashkëpunimi dypalësh në fushën e arsimit dhe shkencës do të forcojë marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve dhe të interesuara për të zhvilluar bashkëpunimin arsimor dhe shkencor me përfitim reciprok, ranë dakord për sa vijon:

Neni 1

Palët do të inkurajojnë dhe mbështesin bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës. Ato do të sigurojnë shkëmbimin e vazhdueshëm të informacionit mbi organizimin e institucioneve arsimore dhe të kërkimeve shkencore në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Palët do të inkurajojnë dhe mbështesin vendosjen e lidhjeve të drejtpërdrejta midis strukturave përkatëse në nivelin e ministrive, të institucioneve arsimore parauniversitare, të universiteteve, si dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë e të shkencës.

Neni 3

Palët do të inkurajojnë dhe mbështesin një pjesëmarrje të gjerë të mësimeve, ekspertëve dhe kërkuesve shkencorë në seminare, simpoziume dhe konferenca ndërkombëtare të organizuara nga palët.

Neni 4

Palët do të mbështesin një bashkëpunim aktiv të institucioneve të tyre në kuadrin e programeve arsimore të Bashkimit Europian, të Këshillit të Europës dhe të UNESCO-s.

Neni 5

5.1 Palët do të inkurajojnë dhe mbështesin bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve akademike në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës nëpërmjet projekteve të përbashkëta shkencore dhe hulumtuese.

5.2 Palët do të mbështesin pjesëmarrjen e përbashkët të institucioneve arsimore dhe shkencore në projekte të karakterit dypalësh dhe shumëpalësh.

Neni 6

6.1 Palët do të inkurajojnë mobilitetin e studentëve në të dyja kahet. Kandidatët e interesuar aplikojnë direkt në institucionet e arsimit të lartë të palës pritëse. Administrimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga institucioni përkatës i arsimit të lartë të palës pritëse.

6.2 Palët do të ofrojnë bursa për studime universitare, pasuniversitare dhe kërkimore. Numri i bursave do të përcaktohet sipas mundësive të të dy palëve, së paku 10 (dhjetë) në vit.

Neni 7

7.1 Palët do të angazhohen në shkëmbimin e përvojës në fushën e sigurimit të teksteve shkollore për arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë. Ato do të shkëmbejnë rregullisht kurrikulat parauniversitare dhe universitare.

7.2 Palët shprehin angazhimin e tyre për vendosjen e bashkëpunimit në arsimin profesional dhe teknik në fusha me interes të përbashkët, në të gjitha nivelet e arsimit.

Neni 8

Palët do të bashkëpunojnë ngushtë në trajnimin e ekspertëve të administratës arsimore dhe të institucioneve kërkimore.

Neni 9

Palët do të inkurajojnë binjakëzimin e shkollave në të gjitha nivelet. Nxënësit dhe studentët do të shkëmbejnë vizita, duke organizuar aktivitete të përbashkëta kulturore dhe arsimore, si dhe projekte me tema të interesit të përbashkët.

Neni 10

Palët do të shkëmbejnë ekspertë në fushën e akreditimit të arsimit të lartë për shkëmbim përvoja dhe pjesëmarrje në procesin e akreditimit.

Neni 11

Palët do të iniciojnë dhe do të mbështesin bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e institucioneve të tyre arsimore dhe kërkimore në kuadrin e programeve ndërkombëtare dhe rajonale për zhvillimin e arsimit dhe shkencës.

Neni 12

Palët do të punojnë së bashku për lehtësimin e procedurave për njohjen reciproke të certifikatave, diplomave, titujve dhe gradave shkencore, të lëshuara nga institucionet arsimore të të dy palëve.

Neni 13

13.1 Për realizimin e kësaj marrëveshjeje, palët do të ngrënë grupet e punës për: arsimin e lartë, kërkimin shkencor, arsimin parauniversitar, tekstet shkollore, zhvillimin e kurrikulës, arsimin profesional, reformën e decentralizimit, si dhe binjakëzimin e shkollave, që do të takohen në mënyrë të alternuar në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës.

13.2 Grupet e punës të jenë të përbëra nga 3-5 vetë. Ato do të realizojnë vizita në vendin e palës tjetër për shkëmbim eksperience, për një periudhë, maksimumi, deri në 3 ditë.

13.3 Pala dërguese do të përballojë shpenzimet e udhëtimit ndërkombëtar, vajtje-ardhje.

13.4 Pala pritëse do të përballojë shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit, shpenzimet e transportit të brendshëm, si dhe shpenzimet e nevojshme mjekësore, në përputhje me rregullat e saj të brendshme ligjore.

Neni 14

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi të dyja palët të kenë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore për hyrjen e saj në fuqi. Data e njoftimit të fundit konsiderohet të jetë data e hyrjes në fuqi e kësaj marrëveshjeje.

Kjo marrëveshje mund të ndryshojë me pëlqimin e të dy palëve.

Kjo marrëveshje mbetet në fuqi për një periudhë 5 (pesë) vjeçare dhe rinovohet automatikisht për periudha pasuesve pesëvjeçare, nëse njëra prej palëve nuk e njofton palën tjetër, me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për ndërprerjen e saj, të paktën 6 (gjashtë) muaj para afatit të skadimit të marrëveshjes.

Bërë në Tiranë më 8.3.2010, në dy kopje, në gjuhën shqipe.

Për Këshillin e Ministrave të
Republikës së Shqipërisë
MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

Për Qeverinë e Republikës së Kosovës
MINISTRI I ARSIMIT, SHKENCËS DHE
TEKNOLOGJISË
Enver Hoxhaj

VENDIM
Nr.266, datë 21.4.2010

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 5 083 755 (pesë milionë e tetëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë) lekësh, për detyrimin ndaj studios ligjore “Grimaldi&Associati”, për përfaqësimin e mbrojtjen në Gjykatën e Apelit, Romë, në çështjen ligjore ndërmjet General Electrics, Athena S.P.A, vs, kundër Republikës së Shqipërisë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit e Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.267, datë 21.4.2010

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR BASHKËRENDIMIN E PUNËS SË ALUIZNI-T ME ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE AGJENCINË E KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE, PËR PROCEDURAT E KALIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI TRUALLIN SHTETËTOR NË ZONAT ME PËRPARËSI TURIZMIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.10 186, datë 5.11.2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit e të Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) bën verifikimi në terren të njërive të ndërtuara menjëherë pas paraqitjes së kërkesës dhe pas kryerjes së parapagesës së tarifës nga subjekti i interesuar apo personi i stimuluar.

2. ALUIZNI, për verifikimin e gjendjes juridike të pronës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga përfundimi i verifikimit në terren i njësisë ndërtimore, kërkon nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP) informacion për gjendjen juridike të zonës së stimuluar, të shoqëruar me kopjen e dokumentacionit që disponohet (kartelë apo regjistër hipotekor, hartë treguese të pasurisë, dokumentacioni ligjor i regjistrimit të pasurive dhe i transaksioneve të mundshme).

3. Nëse ZVRPP-ja konfirmon se zona e stimuluar është pronë shtetërore, ALUIZNI bashkërendon punën edhe me Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) për të evidentuar, kur është e mundur, nëse ka:

a) vendime të ish-komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronës, pranë bashkive ose këshillave të qarkut, ose të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për njohje, kthim ose kompensim të pronës.

b) kërkesa në proces shqyrtimi, të depozituara nga subjekte, të cilat pretendojnë të drejtën e pronësisë mbi zonën e stimuluar.

Kërkesa për marrjen e informacionit i dërgohet AKKP-së, pas përfundimit të afatit të parashikuar në ligj, për paraqitjen e kërkesave nga subjektet e interesuara apo personat e stimuluar.

4. Institucionet e përmendura në pikat 2 e 3 të këtij vendimi, e dërgojnë informacionin e kërkuar, pranë drejtorisë qendrore të ALUIZNI-t, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

5. ALUIZNI, pas verifikimeve të mësipërme, harton relacionin shpjegues sipas pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr.10 186, datë 5.11.2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”.

6. Ngarkohen Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.269, datë 21.4.2010

PËR BLERJEN DHE MONTIMIN E SISTEMIT TË PAJISJEVE PËR BLOKIMIN E VALËVE TË TELEFONISË SË LËVIZSHME NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me fondin prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh, të vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, të blejë dhe të montojë sistemin e pajisjeve për bllokimin e valëve të telefonisë së lëvizshme në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

II. Përzgjedhjen e jo më pak se dy operatorëve ekonomikë, të njohur për ofrimin e këtij shërbimi, të cilëve u dërgohet ftesa për ofertë, për realizimin e blerjes e të montimit të pajisjeve për bllokimin e valëve të telefonisë së lëvizshme.

III. Procedura për realizimin e procesit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, është, si më poshtë vijon:

1. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, mblidhet komisioni i hartimit të dokumenteve standarde, me këtë përbërje:

- 1 përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë kryetar;
- 1 përfaqësues nga Ministria e Brendshme anëtar;
- 1 përfaqësues nga Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit anëtar;
- 1 përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit anëtar;
- 1 përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve anëtar.

2. Institucionet e përmendura në pikën 1, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, i dërgojnë Ministrit të Drejtësisë emrat e përfaqësuesve të tyre në këtë komision, të cilët duhet të jenë specialistë të fushës.

Kryetari i komisionit njofton anëtarët për datën, orën dhe vendin e mbledhjes.

3. Komisioni i hartimit të dokumenteve standarde është përgjegjës për:

- a) përcaktimin e standardeve të pajisjes për bllokimin e valëve të telefonisë së lëvizshme;

b) përzgjedhjen e operatorëve, të cilëve do t'u dërgohet ftesa për ofertë;
c) përcaktimin e kriterëve për vlerësimin dhe për përzgjedhjen e operatorit ekonomik;
ç) përgatitjen e ftesës për ofertë, të cilën e dërgon në adresat përkatëse të operatorëve ekonomikë. Në ftesë përcaktohen:

- i) institucionet në favor të të cilave do të bëhet blerja dhe montimi i pajisjeve;
- ii) standardet e kërkuara për pajisjen, si dhe kriteret e tjera të veçanta;
- iii) data, ora dhe vendi i paraqitjes së ofertës;
- d) çdo element tjetër i vlerësuar si i nevojshëm.

4. Dokumentacioni i paraqitur nga operatorët ekonomikë ruhet dhe nuk hapet deri në datën dhe orën e përcaktuar në ftesën për dorëzimin e ofertave.

5. Komisioni i hartimit të dokumenteve standarde përmbush përgjegjësitë e përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e mbledhjes së parë të këtij Komisioni.

6. Brenda 2 (dy) ditëve nga mbarimi i afatit të dorëzimit të ofertës, mbledhet komisioni i vlerësimit të ofertave, me këtë përbërje:

- 1 përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë kryetar;
- 1 përfaqësues nga Ministria e Brendshme anëtar;
- 1 përfaqësues nga Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit anëtar;
- 1 përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit anëtar;
- 1 përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve anëtar.

7. Institucionet e përmendura në pikën 6, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, i dërgojnë Ministrit të Drejtësisë emrat e përfaqësuesve të tyre në këtë komision, të cilët duhet të jenë specialistë të fushës. Kryetari i komisionit njofton anëtarët për datën, orën dhe vendin e mbledhjes.

8. Komisioni i vlerësimit të ofertave mbledhet dhe shqyrton të gjitha ofertat e paraqitura. Në marrjen e vendimit përfundimtar të përzgjedhjes së subjektit, komisioni bazohet respektivisht në:

- a) plotësimin e kriterëve të përgjithshme teknike;
- b) cilësinë e pajisjes së ofruar;
- c) çmimin më të ulët dhe në shërbimin e ofruar nga subjektet e interesuara për blerjen dhe montimin e pajisjes;
- ç) reputacionin e operatorit ekonomik.

Rëndësia e secilës prej kriterëve të sipërpërmendura do të përcaktohet në dokumentet standarde, gjë për të cilën do të njoftohen operatorët ekonomikë.

9. Nëse për ofrimin e shërbimit paraqitet vetëm një subjekt i interesuar, i cili plotëson standardet e kërkuara për pajisjen, si dhe kriteret e tjera të përcaktuara sipas këtij vendimi, komisioni vijon me procedurën e përzgjedhjes së fituesit.

10. Në përfundim të procesit të vlerësimit, vendimi i komisionit u njoftohet operatorëve ekonomikë, të cilët brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit, kanë të drejtë t'i paraqesin ankime Ministrit të Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë shqyrton dhe vendos mbi ankesën, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së saj.

11. Nëse brenda afatit 5-ditor nuk paraqitet ankime, komisioni i dërgon vendimin, së bashku me relacioni shpjegues, Ministrit të Drejtësisë, i cili, brenda 5 (pesë) ditëve, miraton ose refuzon shpalljen e fituesit.

12. Komisioni i vlerësimit të ofertave, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e shpalljes së fituesit nga Ministri i Drejtësisë, njofton operatorët ekonomikë për klasifikimin përfundimtar të ofertave.

IV. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Brendshëm, Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.271, datë 21.4.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË BRENDSHME, PËR NËNPREFEKTIN E SARANDËS E ADMINISTRATËN E TIJ DHE PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË EMERGJENCAVE CIVILE (DREJTORIA E PMNZSH-SË)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për nënprefektin e Sarandës e administratën e tij dhe për Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile (Drejtoria e PMNZSH-së), sipas formularit bashkëlidhur.

Lista që i bashkëlidhet këtij vendimi përbëhet nga 1 (një) fletë.

2. Nuk lejohet tjetërsimi ose ndërrimi i destinacionit të pronave, të përcaktuara në këtë vendim, apo dhënia në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, nënprefekti i Sarandës dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.272, datë 21.4.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS QENDËR LIBOHOVË TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qendër Libohovë të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Qendër Libohovë të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.840, datë 22.7.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Qendër Libohovë të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Qendër Libohovë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-5	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
4-8	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e kulturës, historisë dhe sporteve.	Në pronësi
9-13	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë.	Në pronësi
14-19	Shërbime funerale	Në pronësi
20-242 243-408 (sheshe) 527-656 (rrugë)	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbime publike	Në pronësi
409	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
474-476,478-479,481-485,487-488	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë (tokë bujqësore produktive).	Në përdorim
477,480,486,489-491	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë (tokë bujqësore joproduktive).	Në përdorim
492-526 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren në fushën e kullimit dhe të ujitjes.	Në pronësi
	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes kombëtare.	Në pronësi
659-660	Prona që përdoren në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
661-676	Burime natyrore	Në përdorim

VENDIM**Nr.275, datë 26.4.2010**

**PËR RISTRUKTURIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE ME KAPITAL SHTETËROR
“ALBPETROL” SHA, PATOS, “UZINA MEKANIKE E NAFTËS, KUÇOVË” SHPK DHE
“UZINA MEKANIKE, PATOS” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 215, pika 1, e 216 të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të nenit 4 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkimin me “Albpetrol” sh.a., Patos, me anë të përthithjes të “Uzina mekanike, Patos” sh.p.k., dhe të “Uzina Mekanike e Naftës, Kuçovë” sh.p.k.

2. Të gjithë punonjësit aktualë të shoqërive “Albpetrol” sh.a., “Uzina mekanike, Patos” sh.p.k., dhe “Uzina Mekanike e Naftës, Kuçovë” sh.p.k., që dalin të papunë si pasojë e ristrukturimit dhe që kanë qenë të punësuar në këto shoqëri për një periudhë 1 (një) – vjeçare, pa ndërprerje, përfitojnë nga ky vendim nga data e hyrjes në fuqi të tij. Këta punonjës përfitojnë, për një periudhë njëvjeçare, pagesë me pagë bruto mesatare, mujore, individuale të vitit të fundit të punës. Në përfundim të kësaj periudhe, punonjësit kanë të drejtë të aplikojnë për të ardhurën nga papunësia në zyrat e punësimin.

3. Periudha, gjatë së cilës këta punonjës do të përfitojnë pagesën e përcaktuar në këtë vendim, njihet si periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni pleqërie, invaliditeti dhe familjar, kundrejt pagesës së kontributit në fondin e sigurimit të detyrueshëm shoqëror nga “Albpetrol” sh.a., dhe për këtë periudhë bëhet shënimi përkatës për pagesën në librezën e punës.

4. Fondi i nevojshëm, prej 600,5 (gjashtëqind presje pesë) milionë lekësh, për kryerjen e pagesave të punonjësve, që dalin të papunë nga ristrukturimi i këtyre shoqërive, të përballohet nga likuiditetet e “Albpetrol”, sh.a., e cila do t’i kryejë këto pagesa çdo muaj.

5. Pagesa sipas këtij vendimi ndërpritet kur përfituesit zhvillojnë veprimtari ekonomike në formën e punësimit apo të vetëpunësimit.

6. “Albpetrol” sh.a., do t’i shtohen nga “Uzina mekanike, Patos” sh.p.k. dhe “Uzina mekanike e naftës, Kuçovë”, sh.p.k., të gjitha asetet për zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë sipas inventarëve, të cilat duhet të paraqiten në bilancet e tyre.

7. Sistemimin e detyrimeve të ndërsjella, debitore dhe kreditore, të shoqërive të sipërpërmendura dhe pasqyrimin në bilancin e “Albpetrol” sh.a., të diferencave të rezultuara.

8. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.281, datë 28.4.2010

**PËR KOMPENSIMIN FINANCIAR TË PERSONAVE TË DËMTUAR NGA ZBATIMI I
PROJEKTIT PËR NDËRTIMIN E SHKOLLËS NËNTËVJEÇARE PUBLIKE NË LAGJEN
“MARK LULA”, BASHKIA SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 5.a dhe 5.b të pjesës C të ligjit nr.9603, datë 28.7.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin “Cilësi dhe barazi në arsim””, të ligjit nr.9661, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin “Cilësi dhe barazi në arsim””, të ligjit nr.9717, datë 19.4.2007 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër të huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Bankës së Këshillit të Europës për Zhvillim”, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin financiar të z. Vuksan Vitaj, në vlerën 920 400 (nëntëqind e njëzet mijë e katërqind) lekë, për dëmin e shkaktuar mbi pronën e paluajtshme dhe të luajtshme (veprimtari ekonomike), si rezultat i zbatimit të projektit për ndërtimin e shkollës nëntëvjeçare publike në lagjen “Mark Lula”, bashkia Shkodër.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të mbulohen nga fondet e miratuara, në buxhetin e vitit 2010, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.4, datë 23.4.2010

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.15, DATË 24.7.2007 “PËR
KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE
CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, nenit 5 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, pikës 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.325, datë 19.3.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Paragrafi i tretë dhe i katërt i nenit 8 shfuqizohen.

Neni 2

Paragrafi i tretë i pikës 2 të nenit 8 ndryshohet si më poshtë:

“Ndërmarrja e transportit do të provojë, në bazë të një vlerësimi financiar vjetor të kryer nga ekspertë ose kontabilistë të miratuar, që, çdo vit, ka të paktën në dispozicion kapital:

- a) 4 000 euro për mjetin e parë dhe 2 000 euro për çdo mjet shtesë, kur kryen transport ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve;
- b) 30 000 lekë për mjetin e parë dhe 15 000 lekë për çdo mjet shtesë, kur kryen transport të mallrave dhe të udhëtarëve brenda vendit.
- c) 700 000 lekë për agjenci transporti ndërkombëtar të udhëtarëve.

Përfshirë paragrafit 1, autoriteti kompetent pranon që një ndërmarrje të provojë gjendjen e përshtatshme financiare të saj, me anë të një vërtetimit si një garanci bankare, ose një sigurimi nga një ose më shumë banka ose institucione financiare, përfshirë kompanitë e sigurimit, si një garanci në lidhje me shumën e përcaktuar në paragrafin 1.”.

Neni 3

Pas nenit 8, shtohet neni 8/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 8 /1

1. Një ndërmarrje që përfshihet në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor, duhet të caktojë të paktën një person, si drejtues veprimtarie, i cili plotëson kërkesat sipas shkronjave “a” dhe “c” të nenit 8 të udhëzimit, dhe i cili:

- a) drejton efektivisht dhe vazhdimisht veprimtarinë e transportit të ndërmarrjes;
- b) është punonjës në ndërmarrje si drejtues ose pronar, ose aksionar, ose administrator i saj, ose kur ndërmarrja është një person fizik, është vetë ky person; dhe
- c) është rezident në Shqipëri.

2. Nëse një ndërmarrje transporti nuk plotëson kërkesën e kompetencës profesionale të vendosur në shkronjën “c” të nenit 8 të udhëzimit, autoriteti kompetent i lëshimit të licencës mund të licencojë atë pa drejtues veprimtarie sipas pikës 1 të këtij neni, duke siguruar që:

a) ndërmarrja të caktojë një person, i cili plotëson kërkesat e vendosura në shkronjat “a” dhe “c” të nenit 8 të udhëzimit dhe të cilit i është dhënë e drejta nëpërmjet një kontrate për kryerjen e detyrimeve si drejtues veprimtarie në emër të ndërmarrjes;

b) kontrata e lidhur nga ndërmarrja me personin e përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike, specifikon detyrimet për t’u kryer mbi baza efektive dhe të vazhdueshme nga ky person, dhe tregon përgjegjësitë e tij si drejtues veprimtarie. Detyrimet e specifikuara do të përfshijnë, në veçanti, ato që lidhen me menaxhimin e mirëmbajtjes së mjeteve, verifikimin e kontratave dhe dokumenteve të transportit, veprimet financiare bazë, caktimin e ngarkesave ose shërbimeve për drejtuesit dhe mjetet, dhe verifikimin e procedurave të sigurisë;

c) në aftësinë si drejtues veprimtarie, personi referuar shkronjës “a” të kësaj pike mund të menaxhojë aktivitetet e transportit deri në tri ndërmarrje të ndryshme me seli ose filial brenda të njëjtit rreth që kryejnë transport udhëtarësh ose mallrash brenda vendit ose ndërkombëtar, me kushtin që numri total i mjeteve të ndërmarrjeve që menaxhohen nga një drejtues veprimtarie nuk duhet të kalojë 36 mjete motorike ose mjete të kombinuara.

3. Një drejtues veprimtarie, i caktuar në përputhje me pikën 1, veç kësaj nuk mund të caktohet si drejtues veprimtarie në përputhje me pikën 2 të këtij neni, ose mund të caktohet vetëm në dy ndërmarrje (përfshirë atë sipas pikës 1) me seli ose filial brenda të njëjtit rreth, kur numri total i mjeteve në të dy ndërmarrjet nuk i kalon të 30 mjete motorike ose mjete të kombinuara.

4. Ndërmarrja e transportit do ta njoftojë autoritetin kompetent të lëshimit të licencës për drejtuesin e veprimtarisë së caktuar, si dhe për çdo ndryshim të tij.”.

Neni 4

Pika 3 e nenit 8 ndryshohet si më poshtë:

“3. Kërkesa në lidhje me kompetencën profesionale, plotësohet kur drejtuesi i veprimtarisë është i pajisur me certifikatë përkatëse të kompetencës profesionale për transport të udhëtarëve dhe, ose mallrave, të lëshuar sipas udhëzimit të Ministrit nr.1, datë 28.1.2009.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

VENDIM Nr.17, datë 23.04.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 20.10.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.18/9 Akti, që i përket:

KËRKUES:AVOKATI I POPULLIT, përfaqësuar nga znj.Florina Nuni dhe z.Frederik Paskali, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga znj.Lefterije Lleshi dhe z.Bledar Miloti, me autorizim.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga znj.Marsida Xhaferllari, me autorizim.

OBJEKTI:Shfuqizimi si antikushtetues :

1) i paragrafit të dytë dhe të tretë, të nenit 10 të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të shtuar me ligjin nr. 9701, datë 02.07.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”;

2) i udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 21.11.2007 “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre, që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

3) i neneve 2 dhe 6 të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 31.01.2007 “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 7, 15, 18, 41, 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27-30, 39, 45 dhe 49/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe neni 24/c i ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatit e Popullit” (i ndryshuar).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Sadushi; përfaqësuesit e Avokatit të Popullit që kërkuan pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjektit të interesuar Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave që kërkuar rrëzimin e saj, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 9701, datë 2.4.2007, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.” Neni 5 ka ndryshuar nenin 10 të ligjit, duke shtuar dy paragrafë të tjerë me këtë përmbajtje: *“Në rastet kur, për të njëjtën pasuri, janë bërë më shumë se disa regjistrime, të cilat nuk kanë rrjedhur nga njëri-tjetri, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, regjistruesi, me vendim të arsyetuar, i kërkon Kryeregjistruesit të vendosë fshirjen e regjistrimeve të kryera pas regjistrimit të parë, kur ky i fundit është në përputhje me nenet 192-197 të Kodit Civil, duke bërë shënimin në kolonën përkatëse. Deri në nxjerrjen e vendimit të Kryeregjistruesit për miratimin ose refuzimin e kësaj kërkesë, regjistruesi bën pezullimin e regjistrimit dhe mbi pasurinë nuk mund të kryhen veprime, si dhe njofton palën/palët e interesuara brenda 10 ditëve. Konfirmimi i marrjes së njoftimit depozitohet në dosjen përkatëse.*

Kryeregjistruesi merr vendim brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës. Në rast të mosmarrjes së vendimit nga Kryeregjistruesi, zbatohet neni 328 i Kodit të Procedurës Civile. Vendimi i Kryeregjistruesit i njoftohet palës/palëve të interesuara brenda 10 ditëve dhe konfirmimi i marrjes së njoftimit depozitohet në dosjen përkatëse.”

2. Këshilli i Ministrave, në mbështetje të këtij ligji ka nxjerrë udhëzimin nr. 4, datë 21.11.2007 “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre, që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.” Procedura që lidhet me regjistrimin e fitimit apo kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, të njohura ose të fituara me anë të ligjit, vendimit gjyqësor apo aktit administrativ, pas verifikimit të plotë të elementëve të formës dhe përmbajtjes së aktit përkatës, është parashikuar në Udhëzimin nr. 1, datë 31.01.2007 “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

3. Gjatë zbatimit të legjislacionit të sipërcituar, pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë regjistruar ankesa nga persona fizikë e juridikë, të cilët kanë pretenduar cenimin e interesave të tyre nga këto rregullime ligjore. Këto ankesa janë marrë në shqyrtim nga ana e Avokatit të Popullit, mbi bazën e të cilave, ai ka ushtruar nismën për një gjykim pranë Gjykatës Kushtetuese, në bazë të nenit 134, pika 2 të Kushtetutës.

4. *Kërkuesi, Avokati i Popullit*, ka pretenduar se dispozitat ligjore të kundërshtuara janë antikushtetuese, duke argumentuar se:

4.1 Fshirja e regjistrimeve nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme që barazohet me shpronësimin cenon të drejtën e pronës, të mbrojtur nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i protokollit 1 të KEDNJ;

4.2 Në kundërshtim me rregullimin e nenit 17 të Kushtetutës, dispozitat ligjore të kundërshtuara përbëjnë një ndërhyrje joproporcionale dhe të pamotivuar në aspektin e interesit publik, duke cenuar edhe vetë thelbin e të drejtave dhe lirive themelore;

4.3 Pezullimi i veprimeve mbi pronën dhe fshirja e regjistrimit të mbivendosjeve nga regjistruerit dhe Kryeregjistruerit, pa një proces të rregullt gjyqësor, ka cenuar rëndë të drejtën e pronës, në kuptim të së drejtës së mbrojtur nga neni 42 i Kushtetutës;

4.4 Është cenuar parimi i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve, i mbrojtur nga neni 7 i Kushtetutës, për arsye se normat e kundërshtuara i kanë dhënë një enti administrativ funksione të gjyqësorit, që lidhen me pezullimin e regjistrimit dhe me heqjen e së drejtës së pronësisë;

4.5 Dispozitat ligjore, objekt shqyrtimi, kanë cenuar parimin e sigurisë juridike, për arsye se kanë krijuar për një masë shumë të madhe pronarësh një ambient pasigurie që pasohet dhe me humbjen e besimit tek shteti;

4.6 Është cenuar barazia përpara ligjit, e mbrojtur nga neni 18 i Kushtetutës, për shkak se dispozitat ligjore i njohin të drejtën Kryeregjistruerit të fshijë vetëm regjistrimet që nuk kanë rrjedhur nga njëri-tjetri, duke mos zbatuar të njëjtën procedurë për të gjitha mbivendosjet;

4.7 Kërkuesi është shprehur në kërkesë, si dhe gjatë parashtrimit të pretendimeve të tij në seancë gjyqësore se të njëjtat argumente vlejnë edhe për shpalljen si antikushtetues të udhëzimeve të Këshillit të Ministrave, të kundërshtuar prej tij.

5. *Subjekti i interesuar*, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës duke pretenduar se:

5.1 Në çështjen në shqyrtim, kërkuesi, Avokati i Popullit, ka marrë pozitën procedurale të përfaqësuesit të një personi juridik e të shtetasit, duke përcjellë pretendimet e tyre në një gjykim abstrakt kushtetues. Këto subjekte nuk mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, qoftë edhe duke marrë si përfaqësues Avokatin e Popullit, përveçse në kushtet e kërkuara nga neni 134/2 i Kushtetutës;

5.2 Kërkuesi nuk ka dhënë ndonjë argument se zbatimi i ligjit, objekt gjykimi, ka shkelur të drejtat e njeriut. Fshirja me nënvizim e regjistrimit është një proces administrativ që nuk mund të heqë titullin e pronësisë;

5.3 Ligji me ndryshimet e bëra nuk shkel parimin e sigurisë juridike, por është në mbrojtje të këtij parimi, për arsye se synon të mbrojë pronarin e vërtetë të një pasurie të regjistruar dhe të ndalojë krijimin e mbivendosjeve për shkak të papërgjegjshmërisë së administratës.

6. *Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave*, ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese rrëzimin e kërkesës duke pretenduar se:

6.1 Avokati i Popullit nuk legjitimohet në çështjen në gjykim, pasi kjo çështje mund t'i paraqitet Gjykatës Kushtetuese prej gjykatave të zakonshme. Kërkuesi ka zgjedhur mjetin më ekstrem, duke kapërcyer mjetet e tjera si paraqitja e rekomandimeve apo propozimeve;

6.2 Argumentet e paraqitura në kërkesë janë pasojë e interpretimit të pasaktë dhe të paplotë të tekstit ligjor, nëpërmjet leximit fragmentar, të shkëputur dhe të deformuar të tij;

6.3 Pretendimi për cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve është jashtë rrethit të çështjeve që mund të iniciojë Avokati i Popullit përpara Gjykatës Kushtetuese;

6.4 Në kundërshtim me rregullimin e parashikuar në nenin 60 të Kushtetutës, Avokati i Popullit ka vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për mbrojtjen e situatave, në të cilat individit në mënyrë të paligjshme ka regjistruar titullin e pronësisë. Regjistrimet e mëpasshme nuk mund të ligjërojnë të drejtën e pronësisë për personat, në emër të të cilëve kryhet regjistrimi i paligjshëm;

6.5 Ndryshimet në ligjin ekzistues nuk cenojnë të drejtën e pronësisë dhe as parimin e barazisë para ligjit, por njohin dhe garantojnë të drejtën e pronarit të ligjshëm. Fshirja e regjistrimit bëhet në respekt të kriterëve të nenit 17 të Kushtetutës dhe të praktikës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut;

6.6 Pretendimi për cenimin e nenit 42 të Kushtetutës nuk qëndron, për arsye se hartuesit e Kushtetutës, nëpërmjet formulimit "*për një proces të rregullt ligjor*", kanë pasur për qëllim shtrirjen e kësaj të drejte si në procesin gjyqësor, ashtu edhe në procesin administrativ;

6.7 Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nuk ka marrë funksione që i takojnë pushtetit gjyqësor, për arsye se ky organ shtetëror nuk është ngarkuar për të dhënë drejtësi, por vetëm për të rregulluar administrativisht pasojat e rrjedhura nga veprime të mëparshme, të kryera në kundërshtim me ligjin.

II

A. Lidhur me pretendimin e subjekteve të interesuar për mungesën e legjitimitetit të kërkuarit.

7. E drejta e Avokatit të Popullit për t'iu drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*këtu e në vijim: Gjykata*) ka tashmë një trajtim të qëndrueshëm në jurisprudencën kushtetuese. Avokati i Popullit, si një nga subjektet që mund të vërë në lëvizje Gjykatën, në bazë të nenit 134/2 të Kushtetutës, duhet të justifikojë interesin e tij në çështjen konkrete dhe që lidhet me ushtrimin e funksionit të tij kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme ose të parregullta të organeve të administratës publike. Kur gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave ose njoftimeve që i paraqiten, Avokati i Popullit evidenton shkelje, nga ato të sipërcituara, rekomandon, nëse është e nevojshme, marrjen e masave me karakter normativ. Krahas kësaj një mënyrë tjetër me të cilën ky organ realizon funksionin e tij, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, është dhe vënia në lëvizje e Gjykatës për shfuqizimin e akteve normative, të nxjerra nga organet e administratës publike dhe që rezultojnë të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën. Në raste të tilla, Avokati i Popullit duhet të argumentojë shkeljen konkrete dhe interesin në çështjen që kërkon të shqyrtohet (*shih vendimin nr. 40, datë 16.11.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se përderisa kërkuari është në zbatim të funksioneve dhe të drejtave të tij të parashikuara nga Kushtetuta, ai legjitimohet *ratione personae*.

8. Kërkuari legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është regjistruar në Gjykatë brenda afatit 3-vjeçar të parashikuar nga neni 50 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Ligji bazë “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” është i vitit 1994, por kërkuari i referohet në objektin e kërkesës së tij ndryshimeve të prezantuara me ligjin nr. 9701, datë 2.04.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

9. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, Gjykata vlerëson, se *prima facie* pretendimet e kërkuarit, në tërësinë e tyre janë në juridiksionin e saj, përjashtimisht pretendimit për cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Kërkuari ka pretenduar se dhënia e drejtësisë është e ndarë nga organet që marrin vendime me karakter politik, qofshin të pushtetit ekzekutiv apo legjislativ dhe, për rrjedhojë, fshirja e regjistrimit të pronës nuk mund t'i delegohet një organi administrativ. Gjykata çmon se në funksion të qëndrimeve të mbajtura në jurisprudencën e saj, në rastin konkret, Avokati i Popullit nuk e lidh pretendimin e tij me cenimin e së drejtës, por me subjektin shtetëror, që e kryen këtë shkelje. Parë nga ky këndvështrim, Gjykata vlerëson se kërkuari nuk legjitimohet *ratione materiae* për të ngritur një pretendim të tillë, për arsye se nuk bën pjesë në interesat e Avokatit të Popullit fakti se cilit organ i është caktuar apo i përket kompetenca ligjore përkatëse.

B. Lidhur me pretendimin mbi cenimin e të drejtës së pronës.

10. Gjykata vëren se disa nga pretendimet e parashtruara nga kërkuari kanë në thelbin e tyre cenimin e së drejtës së pronës. Kërkuari ka pretenduar paligjshmërinë e ndërhyrjes në titullin e pronësisë, duke arsyetuar se mënyra e fshirjes së regjistrimeve nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*këtu e në vijim: ZRPP*), sipas paragrafëve të nenit 10 të ligjit të kundërshtuar, barazohet me “shpronësimin”.

11. Kushtetuta, në nenin 41 parashikon se cenimi i së drejtës së pronës si përjashtim mund të bëhet vetëm në formën e “shpronësimit” dhe të “kufizimit”. Kufizimi i ligjshëm që mund t'i bëhet të drejtës së pronësisë, në një rën prej këtyre dy situatave, kërkohet të realizohet me “ligj” dhe “vetëm për interesa publike”. Gjithashtu, nëse kufizimi i së drejtës së pronës është në atë masë sa që barazohet me shpronësimin, atëherë ai është i lejueshëm “vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë”. Në terminologjinë e përdorur nga neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (*këtu e në vijim KEDNJ*), nuk përmendet termi “shpronësim.” KEDNJ i referohet “privimit nga zotërimet”, koncept që sipas Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (*këtu e në vijim GJEDNJ*), përfshin si shpronësimin formal dhe atë *de facto* (*shih vendimin Sporrong & Lönnroth v. Suedisë (1982), dhe Lithgoë v. Mbretërisë së Bashkuar, 1986*).

12. Në rastin në shqyrtim, sipas rregullimit të nenit 10 të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (të ndryshuar nga neni 5 i ligjit nr. 9701, datë 2.4.2007), kur për të njëjtën pasuri, janë bërë më shumë se disa regjistrime, të cilat nuk kanë rrjedhur nga njëri-tjetri dhe kur i pari gjendet në përputhje me ligjin, regjistruesi, me vendim të arsyetuar, i kërkon Kryeregjistruesit të vendosë *fshirjen* e regjistrimeve të kryera pas regjistrimit të parë. Në këtë periudhë kohore, e cila zgjat deri në 30 ditë, regjistrimi *pezullohet* dhe mbi pasurinë nuk mund të kryhet asnjë veprim.

13. Mbi bazën e pretendimeve të paraqitura nga kërkuesi dhe subjektet e interesuara, Gjykata merr në shqyrtim faktin nëse, në rastin në shqyrtim, ka kufizim të së drejtës së pronës dhe nëse janë respektuar nga legjislatori kriteret e vendosura nga neni 17 i Kushtetutës lidhur me kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore me ligj, për një interes publik, për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar.

14. Gjykata çmon se Kushtetuta nuk prezanton ndonjë përkufizim të konceptit të pronësisë, përveçse rregullimit të nenit 41, sipas të cilit: “Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.” Në legjislacionin tonë, sa më sipër, rregullohet përmes nenit 149 të Kodit Civil, i cili parashikon se: “Pronësia është e drejta për të *gëzuar* dhe *disponuar* lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji”, ndërsa në nenet 164-190 parashikohen mënyrat përkatëse të fitimit dhe të humbjes së pronësisë. Sipas nenit 191 të Kodit Civil “heqja dorë nga pronësia mbi pasuritë e paluajtshme në dobi të një tjetri, është e vlefshme kur bëhet me akt noterial e regjistrohet”. Neni 192 parashikon që “Sendet e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjendjen juridike të tyre regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Regjistrimi bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga ligji”. Neni 195 i Kodit Civil parashikon se: “Pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi ato që janë fituar ose njohur sipas dispozitave të këtij Kodi, *nuk mund të tjetërsohen dhe kur është rasti, të ngarkohen me barrë, në rast se nuk është bërë regjistrimi i tyre në regjistrat e pasurive të paluajtshme*”.

15. Nga kjo analizë e dispozitave kushtetuese dhe ligjore Gjykata çmon se regjistrimi rezulton të jetë akt me një rëndësi të posaçme në qarkullimin civil. Ndryshimet ligjore të kundërshtuara nga kërkuesi, në të vërtetë nuk cenojnë drejtpërdrejt *titullin e pronësisë* (qoftë ky “një akt publik”, “një vendim gjyqësor”, “një vendim i një organi tjetër shtetëror kompetent”). Gjykata vlerëson se ndryshimet ligjore, objekt shqyrtimi, nëpërmjet kufizimit *përkohësisht*, deri në 30 ditë që i bëjnë mbajtësit të titullit pronësor që ka kryer regjistrimin e parë dhe, *për një kohë të papërcaktuar* të tjerët e regjistruar në vijim, si dhe fshirjes së regjistrimit të tij, cenojnë njërin prej komponentëve të rëndësishëm të së drejtës së pronës, *disponimin* lirisht të saj, brenda kufijve ligjorë. E drejta për të disponuar është e drejta për ta shitur ose jo sendin, për ta dhuruar, për ta lënë me testament, për ta dhënë atë si garanci reale për garantimin e detyrimeve ndaj të tjerëve, etj. Duke qenë se është kërkesë *sine qua non* e legjislacionit civil që “sendet e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjendjen juridike të tyre regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme” (neni 192 i KC), pasi përndryshe ato “nuk mund të tjetërsohen” apo “të ngarkohen me barrë” (neni 195 i KC), fshirja e regjistrimit të titullit të pronësisë, ndikon drejtpërdrejtë në të drejtën e pronësisë. Nga kjo pikëpamje, Gjykata thekson se fshirja e regjistrimit, ndonëse nuk e zhvesh plotësisht titullarin nga e drejta e pronësisë, në kuptimin formalo juridik të saj, e kufizon në fakt të drejtën e tij të pronësisë, duke e bërë të pamundur disponimin e saj.

16. Në hartimin e dispozitave të ligjit, objekt shqyrtimi, që kanë kufizuar të drejtën e pronës, Gjykata çmon të nevojshme të identifikojë praninë e interesit të ligjshëm. Sipas pretendimeve të subjekteve të interesuara, praktika administrative e regjistrimit të pronësisë ka evidentuar jo pak shkelje të ligjit në drejtim të cenimit të së drejtës së pronarit të ligjshëm, e cila ka shkaktuar paraqitjen e një fluksi të konsiderueshëm çështjesh në gjykatë. Shteti, në ushtrimin e rolit të tij rregullator në shoqëri, ka ndërhyrë për t’i dhënë fund situatës së krijuar dhe për të mbrojtur të drejtën e pronarit të ligjshëm për të gëzuar dhe disponuar lirisht pronën e tij, brenda kufijve të caktuar me ligj. Një situatë e tillë, në vlerësimin e Gjykatës, ka imponuar edhe nevojën për ndryshimin e ligjit për rregullimin e pasojave të ardhura dhe parandalimin e problemeve për të ardhmen. Mbi këtë bazë, Gjykata nënvizon ekzistencën e “interesit publik” për një ndërhyrje që synon, para së gjithash, rikthimin në ligjshmëri të situatës së pronave dhe vendosjen e besimit të qytetarëve te sistemi shoqëror në fuqi.

17. Nëpërmjet jurisprudencës së saj, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: “analiza dhe interpretimi i disa prej koncepteve kushtetuese që kanë të bëjnë me “interesin publik” dhe me “shpërblimin e drejtë”, si dhe respektimi i parimeve të drejtësisë, të proporcionalitetit, apo të shtetit

social përbëjnë njëkohësisht dhe kufijtë kushtetues të hapësirës së vlerësimit, mbi të cilat duhet të orientohet ligjvënësi, për respektimin e së drejtës së pronës” (*shih vendimet nr. 30, datë 1.12.2005 dhe nr. 35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata thekson se në rastin e kufizimit të të drejtave, një masë, për të arritur synimet e saj, duhet të jetë sa e përshtatshme, aq edhe proporcionale. Për vlerësimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes së ligjvënësit, me pasojë shkeljen e të drejtave individuale të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji, duhen marrë në shqyrtim balanca ndërmjet dëmit të shkaktuar individit dhe fitimit të shoqërisë, masa e mbrojtjes nga arbitrariteti që ofrojnë procedurat ligjore si dhe mundësia e shtetit për të përdorur mënyra a mjete të tjera për të arritur qëllimin. Shteti, brenda mundësive, duhet të kufizojë ndërhyrjen në minimum, duke kërkuar zgjidhje alternative dhe, përgjithësisht, duke u përpjekur t’i arrijë qëllimet në mënyrë sa më pak të dëmshme nga pikëpamja e të drejtave të njeriut (*shih më gjerë vendimin Hatton & të tjerë v. Mbretërisë së Bashkuar (2001)*).

19. Mbi këtë analizë, Gjykata vlerëson se fshirja e regjistrimit, ndonëse nuk e zhvesh plotësisht titullarin nga e drejta e pronësisë, në të vërtetë e privon atë nga e drejta për të disponuar lirisht mbi pronën e tij. Nga ana tjetër, megjithëse interesi i legjislatorit është legjitim, fakti që pronari, i cili e ka regjistruar më pas në kohë titullin e tij të pronësisë, nuk do të mund ta gëzojë pronën në tërësinë e saj për një kohë të papërcaktuar, nuk krijon një situatë të balancuar ndërmjet interesit publik dhe interesave privatë të cenuar, veçanërisht për sa i përket mjetit jo proporcional të përdorur. Në të njëjtën kohë, konstatohet se, në rastin e fshirjes së regjistrimit, megjithëse parashikohet e drejta për ankim në rrugë gjyqësore, sipas ligjit në shqyrtim, ky ankim është i lidhur me kundërshtimin e aktit administrativ dhe jo me thelbin e të drejtës së pronësisë. Duke vlerësuar mjetin e zgjedhur nga legjislatori për të arritur qëllimin e tij, Gjykata arrin në përfundimin se mjeti është kufizues dhe disproporcional. Nga kjo pikëpamje, Gjykata konkludon se dispozita ligjore objekt shqyrtimi ka cenuar të drejtën e pronës, të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës.

C. Lidhur me pretendimin mbi cenimin e parimit të sigurisë juridike

20. Sipas kërkesit, neni 10 i ligjit, objekt shqyrtimi krijon një ambient pasigurie për një masë shumë të madhe pronarësh që pasohet me një humbje të besueshmërisë tek shteti dhe që lë shteg për abuzime, subjektivizëm dhe selektivitet gjatë zbatimit të tij. Ligjvënësi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara ose të shpërfillë interesat legjitime të tyre dhe t’i jap ligjit fuqi prapavepruese.

21. Siç është shprehur Gjykata në jurisprudencën e saj: “parimi kushtetues i shtetit të së drejtës do të konsiderohet i dhunuar, nëse mohohen ose shkelen siguria juridike, stabiliteti ligjor dhe mbrojtja e pritshmërive të ligjshme. Ligjvënësi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara ose të shpërfillë interesat legjitime të tyre.” (*shih më gjerë vendimin nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Sipas ligjit, objekt shqyrtimi, ZRPP-ja është ngarkuar me mbajtjen e regjistrit publik, në të cilin pasqyrohet pronësia mbi një pronë të paluajtshme dhe transferimet e ndryshme që i bëhen asaj. Me qëllim kryerjen e transaksioneve të vlefshme të transferimit të pronësisë kërkohen elementë të natyrës publike siç janë forma noteriale dhe regjistrimi në regjistrin e pronës. Në vlerësimin e Gjykatës, regjistri publik i regjistrimit të pasurive të paluajtshme duhet të jetë një regjistër i sigurt dhe i besueshëm. Roli i tij në sistem është i një rëndësie themelore duke pasur parasysh se përmes tij ngurtësohen të drejta subjektive. Mungesa e besueshmërisë në regjistrin publik sjellë pasiguri në qarkullimin civil. Gjykata vlerëson se krijimi i një gjendje pasigurie juridike në këto regjistra nuk mund të korrigjohet me zgjidhje që imponojnë veprime po aq të pasigurta, siç është fshirja e regjistrimit që kryhet nga Kryeregjistruesi. Kthimi në gjendjen e ligjshmërisë të situatës në të cilën gjendet regjimi i pronës, nuk mund të bëhet me mjete jo ligjore.

23. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se fshirja e regjistrimit të pronës nga një strukturë administrative kufizon të drejtën e pronësisë dhe krijon një pasiguri juridike për shtetasit, duke cenuar në të njëjtën kohë dhe të drejtat e fituara.

Ç. Lidhur me pretendimin mbi cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor

24. Në kërkesën e Avokatit të Popullit, koncepti i procesit të rregullt ligjor është parë në kuptim të atij gjyqësor. Kërkuesi pretendon se e drejta për një proces të rregullt është cenuar, për arsye se fshirja e regjistrimit të titullit të pronësisë nuk bëhet nëpërmjet një vendimi gjyqësor, ku dhe respektohen elementet e procesit të rregullt, por nga një strukturë administrative. Pezullimi i veprimeve mbi pronën dhe fshirja e regjistrimit të mbivendosjeve nga regjistruesi dhe kryeregjistruesi, pa një proces të rregullt

gjyqësor, cenon rëndë të drejtën e pronës.

25. E drejta për një proces të rregullt ligjor, si një e drejtë me karakter procedural, e sanksionuar nga Kushtetuta, për të siguruar mbrojtjen e një të drejte tjetër kushtetuese dhe ligjore (që në këtë rast është e drejta e pronës), është kuptuar nga kërkuesi në komponentin e saj “gjyqësor”. Parimin kushtetues të së drejtës për një proces të rregullt ligjor Gjykata e ka përpunuar dhe shtjelluar të lidhur me elementet e një procesi të rregullt gjyqësor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe 6 të KEDNJ. Në vendimet e saj, Gjykata ka theksuar se çdo organ i pushtetit publik gjatë ushtrimit të funksioneve të tij kushtetuese e ligjore është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike që lidhen me procesin e rregullt, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë (*shih vendimin nr. 75, datë 19.04.2002 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata vlerëson se kushtetutbërësi, duke parashikuar në nenin 42/1 të Kushtetutës se: “Liria, prona dhe të drejtat e tjera të njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor”, nuk duket se e ka përjashtuar mundësinë e cenimit të këtyre të drejtave edhe përmes procedurave administrative, mjaft që ato të jenë të rregullta. Fakti i gjithëpranuar se procedura gjyqësore ofron më shumë garanci për qytetarin nuk do të thotë a priori që procedura administrative është e parregullt, kur që të dyja janë të parashikuara nga ligji. Gjykata, bazuar në argumentet e mësipërme, sipas të cilave, parimi i sigurisë juridike është i cenuar nëpërmjet fshirjes nga një organ ekzekutiv i regjistrimit të titullit të pronësisë, që përbën një nga të drejtat bazë të pronarit, të fituar sipas formave të parashikuara nga ligji, konsideron të papranueshëm cenimin e të drejtës edhe në kapërcim të standardit kushtetues për një proces të rregullt ligjor.

27. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit se e drejta e pronës, e fituar përmes një akti publik apo vendimi gjyqësor të formës së prerë, nuk mund të cenohet në këtë masë dhe për një kohë kaq të papërcaktuar përmes një procedure administrative, përveçse një procedurë gjyqësore, është i drejtë dhe duhet pranuar.

D. Lidhur me pretendimin mbi shfuqizimin si antikushtetues të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 21.11.2007 “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre, që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”

28. Kërkuesi ka kërkuar nga Gjykata shpalljen si antikushtetues të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 21.11.2007, “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre, që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”. Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka parashtruar posaçërisht ndonjë argument në lidhje me këtë pretendim, por është kufizuar në referimin tek argumentet e tij për antikushtetueshmërinë e paragrafëve të dytë dhe të tretë të nenit 10 të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”(të ndryshuar).

29. Pasi e analizoi në mënyrë integrale udhëzimin e sipërcituar, Gjykata çmon se ky akt nënlidhës është nxjerrë në bazë të nenit 56 të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”(të ndryshuar) dhe për të mundësuar zbatimin e nenit 10 të tij. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se me shfuqizimin e nenit 10 të ligjit, objekt shqyrtimi, nuk ka më bazë ligjore për ekzistencën në korpusin e legjislacionit edhe të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 21.11.2007 “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre, që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.”

30. Në këtë kontekst dhe duke u mbështetur në nenin 48 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë,” Gjykata vëren lidhjen *sine qua non* ndërmjet nenit 10, të analizuar më lart dhe paragrafit të dytë të nenit 39/a të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”(të ndryshuar). Në këtë dispozitë ligjore thuhet: “Nëse regjistruesi është vënë në dijeni se një regjistrim i mëparshëm është kryer në kundërshtim me këtë nen, atëherë ai procedon sipas nenit 10 të këtij ligji”. Përderisa, regjistruesi në kryerjen e veprimeve duhet të referohet në nenin 10 të ligjit, mbi të njëjtat argumente të përdorura më lartë Gjykata konkludon për papajtueshmërinë me Kushtetutën edhe të paragrafit të dytë të nenit 39/a të ligjit, objekt shqyrtimi.

DH. Lidhur me pretendimet mbi shfuqizimin si antikushtetuese të neneve 2 dhe 6 të udhëzimit të KM nr. 1, datë 31.01.2007 “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.”

31. Gjykata vëren se edhe për këtë akt normativ kërkuesi nuk ka parashtruar argumente, duke u mjaftuar me referimin tek argumentet për antikushtetutshmërinë e paragrafëve të dytë dhe të tretë të nenit 10 të ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”(të ndryshuar). Gjykata konstaton se ky akt normativ ka dalë përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 9701, datë 2.4.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” që solli ndryshimin e nenit 10, të kundërshtuar nga kërkuesi. Pra, baza ligjore e udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 31.01.2007 “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, nuk ka lidhje me dispozitën e sipërcituar. Për rrjedhojë, përderisa ndërmjet përmbajtjes së këtij udhëzimi të Këshillit të Ministrave dhe neneve 10, e 39/a të ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”(të ndryshuar) nuk ka ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë, si dhe duke pasur parasysh mosparashtrimin nga ana e kërkuesit të ndonjë argumenti kushtetues për antikushtetutshmërinë e aktit objekt shqyrtimi, Gjykata konkludon, se në lidhje me këtë pretendim, kërkesa nuk duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronjat “a” dhe “c” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “dh” të Kushtetutës, si dhe të neneve 49, 50, 51 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të paragrafit të dytë dhe të tretë të nenit 10 dhe të paragrafit të dytë të nenit 39/a të ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të shtuar me ligjin nr. 9701, datë 2.07.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.4, datë 21.11.2007 “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre, që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

- Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e neneve 2 dhe 6 të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 31.01.2007 “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vladimir Kristo (kryetar), Petrit Plloçi, Sokol Berberi.

Anëtarë kundër: Sokol Sadushi, Admir Thanza, Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori.

MENDIM PAKICE

Në vlerësimin tonë, kërkesa e Avokatit të Popullit, me objekt: “Shfuqizimin si antikushtetues të paragrafit të dytë dhe të tretë të nenit 10 të ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (të ndryshuar); të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 21.11.2007, “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”; të neneve 2 dhe 6 të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 31.01.2007 “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, është e pambështetur në nenet 4, 7, 15, 18, 41, 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në parashtrimet për argumentimin e antikushtetutshmërisë së dispozitave të sipërcituara kërkuesi i është referuar konceptit të *së drejtës së pronës, të mbrojtur nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i protokollit 1 të KEDNJ; kufizimit të kësaj të drejte në kundërshtim me rregullimin e nenit 17 të Kushtetutës; të drejtës për një proces të rregullt ligjor, të mbrojtur nga neni 42 i Kushtetutës; parimit të ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, të parashikuar nga neni 7 i Kushtetutës; parimit të sigurisë juridike si dhe standardit të barazisë përpara ligjit, të mbrojtur nga neni 18 i Kushtetutës;*

Për shkak se pretendimet e kërkuesit, në thelb, kanë të bëjnë me *cenimin e së drejtës themelore të pronës*, nga cenimi i të cilës, sipas tij, rrjedh edhe cenimi i të drejtave të tjera, gjyqtarët në pakicë e

vlerësojnë të domosdoshme të analizojnë dy aspekte që kanë rëndësi për çështjen: *kuptimin juridik të pronësisë, si dhe objektin, rolin dhe rëndësinë që paraqet veprimtaria e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme* (ZRRP) dhe ndikimin që ajo sjell mbi të drejtën e pronës.

Neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton të drejtën e pronës, por nuk përcakton kuptimin juridik të saj, i cili jepet qartësisht në dispozitat e Kodit Civil. Vetë neni 41 i Kushtetutës, sa i përket mënyrave të fitimit të pronësisë, të referon në Kodin Civil. Për këtë arsye është e domosdoshme që t'i drejtohem Kodit Civil. Sipas nenit 149 të tij "...pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji", ndërsa sipas nenit 163 "...pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë".

Kuptimi juridik i pronësisë lidhet pazgjidhshmërisht me kuptimin juridik të sendit. Kodi Civil, në nenin 142, duke përcaktuar llojet e sendeve, i ndan ato në sende të luajtshme dhe sende të paluajtshme, ndërsa në nenin 144 parashikon se: "...sendet e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to regjistrohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme". Ky rregullim ligjor përsëritet në mënyrë më të detajuar edhe në nenet 192-198 të Kodit Civil.

Referuar këtyre dispozitave ligjore rezultojnë, se regjistri që mban ZRPP është një regjistër publik nën administrimin e Ministrisë së Drejtësisë që ka për qëllim mbajtjen, evidentimin dhe publikimin e fakteve juridike krijuese, ndryshuese dhe shuese të së drejtës së pronësisë dhe të drejtave reale mbi të pasuritë, (sendet) e paluajtshme, ç'ka rezultojnë të jetë edhe objekti i veprimtarisë së kësaj zyre shtetërore të specializuar. Faktet juridike që krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë të drejtën e pronësisë ose të drejtat reale mbi pasuritë, (sendet) e paluajtshme duhet të rezultojnë nga akte publike, (titujt e regjistrimit) siç mund të jenë një vendim gjykate, një akt administrativ ose një akt noterial. Kushtet, mënyra e regjistrimit dhe e organizimit, si dhe çdo procedurë që ka lidhje me regjistrimin e titujve të pronësisë është rregulluar me ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" (të ndryshuar).

Bazuar në këtë ligj, regjistrimi për herë të parë në mënyrë të rregullt dhe ligjore i një titulli pronësie nga ZRPP-ja shoqërohet domosdoshmërisht me hapjen e një karteje, ku evidentohen të gjithë elementet e domosdoshme që individualizojnë sendet, objekt regjistrimi. Sipas ligjit, prona shënohet në një fletë të volumnit të regjistrimit, që mbahet për çdo pasuri të paluajtshme. Kësaj prone i vendoset një numër dhe plani i rievimit, i cili është dokumenti që, si pjesë e regjistrimit, tregon kufijtë e një pasurie të paluajtshme. Këto të dhëna hidhen dhe pasqyrohen në hartën treguese të regjistrimit, që i përket zonës së regjistrimit. Mbi bazën e tyre nxirret certifikata e pronësisë që i jepet pronarit dhe që pasqyron të gjithë informacionet që ndodhen në kartelën e kësaj pasurie. Nga sa më sipër rezultojnë se regjistrimi për herë të parë i titullit të pronësisë në regjistrat e pasurive të paluajtshme ka si pjesë të domosdoshme të rregullshmërisë dhe ligjshmërisë së tij jo vetëm pasqyrimin e pronës me fjalë në kartelën, faqen e regjistrimit, por edhe përcaktimin e pronës hartografikisht duke hedhur dhe pasqyruar edhe planin e rievimit të saj në hartën treguese të regjistrimit. Vetëm pas realizimit të këtyre veprimeve administrative regjistrimi i titullit të pronësisë konsiderohet si një regjistrim i plotë, i rregullt dhe ligjor.

Mbajtja dhe administrimi i mirë i regjistrimit të pasurive të paluajtshme që ligjërisht dhe objektivisht nuk njihet dhe nuk lejon mbivendosje të regjistrimeve të titujve të pronësisë që nuk rrjedhin nga njeri-tjetri, përmbush interesin më të lartë të publikut dhe garanton parimin kushtetues të sigurisë juridike në qarkullimin civil. Gjithashtu, mbajtja dhe administrimi i mirë i regjistrimit të pasurive të paluajtshme përbën siguri juridike edhe për operatorët e tregut të kapitaleve, siç janë bankat, të cilat lehtësojnë qarkullimin civil të sendeve të paluajtshme nëpërmjet dhënies së kredive kundrejt garancisë së kolateralit që zakonisht përfaqësohet nga sendet e paluajtshme. Në kushtet e ekonomisë shqiptare, si një ekonomi në zhvillim dhe me shumë nevojë për investime të huaja, mbajtja dhe administrimi i mirë i regjistrimit të pasurive të paluajtshme përbën një nga kushtet kryesore për sigurinë e këtyre investimeve, pa përmbushjen e të cilit nuk mund të ketë zhvillim të vendit.

Regjistrimi, mbajtja, evidentimi dhe publikimi i fakteve juridike krijuese, ndryshuese dhe shuese të pronësisë dhe të drejtave reale mbi të pasuritë e paluajtshme nga ana e Z.R.P.P-së, është një veprimtari publike. Administrimi i rregullt dhe ligjor i regjistrimit të pasurive të paluajtshme është detyrë dhe përgjegjësi funksionale e regjistruesit të këtyre zyrave, të cilët nga pikëpamja administrative varen nga kryeregjistruesi i zyrës qendrore.

Bazuar në jurisprudencën e kësaj Gjykate se zbatimi dhe interpretimi i ligjit është në juridiksion të gjykatave të zakonshme si dhe, në vendimin Unifikues nr.1 datë 6.01.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat në ushtrim të funksionit të tyre kushtetues të sanksionuar në nenin 141/2 të

Kushtetutës kanë njësuar praktikën gjyqësore në lidhje me interpretimin e nenit 83 të Kodit Civil, gjyqtarët në pakicë konstatojnë se *regjistrimi ka për funksion vetëm publikimin e faktit juridik të pronësisë dhe jo krijimin e kësaj të drejte*, e cila krijohet me akt publik përkatës. Regjistrimi është një formalitet që pasqyron veprimin juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme që nuk duhet të konfundohet me formën e veprimit juridik. Megjithatë, regjistrimi krijon një efekt mbi qarkullimin e sendeve të paluajtshme. Shoqëritë moderne të kapitalit karakterizohen nga lehtësia e qarkullimit të sendeve për shkak se sa më shumë dhe më shpejt që të qarkullojnë sendet, aq më shumë dhe më shpejt rritet ekonomia e vendit. Në këtë aspekt lehtësia dhe shpejtësia e qarkullimit të sendeve është një interes publik i përgjithshëm. Megjithatë vetë ligji ka përcaktuar se qarkullimi i sendeve të paluajtshme për shkak se karakterizohet nga forma më komplekse është më pak i shpejtë se qarkullimi i sendeve të luajtshme dhe interesi vetjak i pronarit për të ruajtur pronësinë gjen një mbrojtje më të madhe. Në aspektin e qarkullimit sendet e paluajtshme paraqiten si forma më e garantuar e pronësisë.

Bazuar në nenin 41/2 të Kushtetutës dhe në dispozitat e Kodit Civil e drejta e pronësisë nga këndvështrimi subjektiv ndryshon me kalimin e kohës, ajo mund të shuhet ose të ndryshojë, qoftë edhe pjesërisht ndaj një individi në favor të një individi tjetër. Neni 195 i Kodit Civil dhe neni 9 i ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, në thelb, sanksionojnë *parimin e vazhdimësisë së regjistrimeve*, që lidhet me ndryshimin e së drejtës së pronës nga këndvështrimi subjektiv, pasi prona të jetë regjistruar fillimisht në mënyrë të rregullt, të plotë dhe ligjore në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Parimi i vazhdimësisë së regjistrimeve është pranuar si një parim bazë në të cilin mbështetet regjistrimi. Gjyqtarët në pakicë janë të mendimit se pa këtë parim, regjistrimi do të humbiste kuptimin dhe qëllimin e tij. Pikërisht referimi tek ky parim nuk rezulton të ketë gjetur pasqyrim në argumentet e shumicës. Ky parim në vetvete është mjet për të garantuar një tjetër parim kushtetues, atë të sigurisë juridike. Pra, mund të blihet një send i paluajtshëm me siguri të plotë vetëm në qoftë se nga regjistri i pasurive të paluajtshme të rezultojë një seri e vazhdueshme regjistrimesh deri tek pronari fillestar.

Kuvendi i Shqipërisë, ka miratuar ligjin nr. 9701, datë 2.4.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar. Neni 5 i këtij ligji, objekt i kundërshtimit kushtetues, parashikon se në rastet kur për të njëjtën pasuri janë bërë më shumë se disa regjistrime, të cilat nuk kanë rrjedhur nga njëri-tjetri, regjistruesi, me vendim të arsyetuar, i kërkon kryeregjistruesit të vendosë *fshirjen* e regjistrimeve të kryera pas regjistrimit të parë, (kur i pari gjendet në përputhje me ligjin). Në këtë kohë, regjistrimi *pezullohet* dhe mbi pasurinë nuk mund të kryhet asnjë veprim, për një periudhë 30-ditore.

Pakica është e mendimit se neni 5 i këtij ligji nuk bën gjë tjetër veçse garanton parimin e vazhdimësisë së regjistrimit dhe parimin kushtetues të sigurisë juridike, ç’ka rezulton që të jetë edhe qëllimi i legjislatorit. Mjeti i përdorur nga legjislatori, në këtë rast, është e drejta ligjore e kryeregjistruesit për të vendosur fshirjen e regjistrimeve të kryera pas regjistrimit të parë, (kur i pari gjendet në përputhje me ligjin), mbi kërkesën dhe me vendim të arsyetuar të regjistruesit. Ky mjet ligjor i është njohur atij për shkak të situatës objektive të mbivendosjes së titujve të regjistrimit të pronësisë që nuk rrjedhin nga njeri tjetri. Duke qenë se administrimi i rregullt dhe ligjor i regjistrimit të pasurive të paluajtshme është detyrë dhe përgjegjësi funksionale vetëm e regjistruesit të këtyre zyrave, i cili nga pikëpamja administrative varet nga kryeregjistruesi i zyrës qendrore, pakica çmon se kjo e drejtë dhe kompetencë ligjore që u është njohur atyre nga dispozita objekt shqyrtimi, është mjeti i vetëm i përshtatshëm.

Siç u parashtua më sipër, gjyqtarët në pakicë janë të mendimit se regjistrimi ka funksion vetëm publikimin e faktit juridik të pronësisë dhe jo krijimin e kësaj të drejte. E drejta e pronësisë krijohet vetëm me aktin publik, i cili përbën titullin e regjistrimit. Për këtë arsye fshirja e regjistrimit të dytë, kur ai nuk vjen nga regjistrimi i parë, jo vetëm është mjeti i vetëm i përshtatshëm, por ky mjet nuk cenon thelbin e të drejtës së pronës, të krijuar nga akti publik. Ashtu siç janë shprehur edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues, të cituar më sipër, e drejta e pronësisë që rezulton nga akti publik qoftë dhe e pa regjistruar gëzon mbrojtje juridike të lartë ndaj të drejtës së pronësisë, që rezulton nga akti publik i regjistruar i pari. Gjyqtarët në pakicë janë të mendimit se legjislatori, në dhënien e kompetencës ligjore kryeregjistruesit për të vendosur fshirjen e regjistrimeve të kryera pas regjistrimit të parë, nuk i ka dhënë atij të drejtën për të gjykuar se cili nga titujt e pronësisë është i vlefshëm, pasi një gjë e tillë do cenonte jo vetëm thelbin e të drejtës së pronës, por edhe parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, të sanksionuar nga neni 7 i Kushtetutës. Bazuar në nenin 42 të

Kushtetutës dhe në dispozitat e Kodit Civil, është e njohur se shqyrtimi i vlefshmërisë ose jo të titujve të pronësisë i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme.

Në fakt legjislatori, në dhënien e këtij mjeti kryeregjistruesit është bazuar në një tjetër parim të rëndësishëm të regjistrimit, që është *parimi i prioritetit në kohë* ose i *përparësisë së pronësive të regjistruara*, sanksionuar në nenin 10 të ligjit bazë. Parimi i *prioritetit në kohë* ose i *përparësisë së pronësive të regjistruara*, buron nga kërkesat ligjore për të evidentuar në regjistër sendet e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjendjen e tyre juridike, (nenet 144 dhe 192 të KC), i cili është një mjet që garanton parimin kushtetues të sigurisë juridike në aspektin e qarkullimit civil të sendeve të paluajtshme. Gjithashtu, formaliteti ligjor i regjistrimit që konsiston në mbajtjen dhe evidentimin e sendeve të paluajtshme është një nga mjetet e ushtrimit të sovranitetit të pushtetit mbi territorin e shtetit, një aspekt i të cilit shfaqet edhe në shpronësimin e tyre për interes publik.

Për të realizuar dhe përmbushur këtë formalitet ligjor, legjislatori i vetëdijshëm se gjatë regjistrimit fillestar apo edhe gjatë veprimtarisë së mëtejshme të zyrave të regjistrimit mund të krijoheshin mbivendosje ndërmjet titujve të pronësisë që nuk rrjedhin nga njëri-tjetri, si dhe duke pasur në konsideratë që mbajtja dhe administrimi i mirë i regjistrimit është interesi më i lartë publik, në nenin 10 të ligjit bazë ka sanksionuar *parimin e prioritetit në kohë* ose të *përparësisë së pronësive të regjistruara*. Në zbatim të këtij parimi, regjistruesi duhet të regjistrojë vetëm titullin e regjistrimit që është paraqitur i pari në mënyrë të përshtatshme nga aspekti dokumentar, pavarësisht nga data e përpilimit të tij dhe pavarësisht se shënimi në kartelë mund të vonohet, duke refuzuar në regjistrimin e titullit që mbivendosej me titullin e regjistruar, kur ata nuk rrjedhin nga njëri tjetri. Parimi i *prioritetit në kohë* ose i *përparësisë së pronësive të regjistruara* është një parim formal për shkak se legjislatori, në përcaktimin se cili nga titujt e regjistrimit duhet të regjistrohet në se ata mbivendosen dhe nuk rrjedhin nga njëri tjetri nuk i ka dhënë të drejtën regjistruesit për të gjykuar se cili prej tyre është i vlefshëm dhe cili jo, dhe që mbi bazën e këtij vlerësimi ai të bëjë regjistrimin. Përkundrazi, diskrecioni i vetëm që legjislatori i ka dhënë regjistruesit është prioriteti në kohë i paraqitjes së dokumenteve të titullit të regjistrimit në mënyrë të përshtatshme, i cili në vetvete është një fakt objektiv. Edhe refuzimi nga ana e regjistruesit i regjistrimit të dytë kur ai nuk vjen nga regjistrimi i parë është, sipas mendimit të pakicës, jo vetëm mjeti i vetëm më i përshtatshëm, por ky mjet nuk cenon thelbin e të drejtës së pronës, të krijuar nga akti publik që nuk regjistrohet. Në referencë të analizës së bërë më lartë, e drejta e pronësisë që rezulton nga akti publik i paregjistruar gëzon një mbrojtje të lartë juridike që garantohet nga neni 42 i Kushtetutës, edhe ndaj të drejtës së pronësisë që do të rezultojë nga akti publik i regjistruar i pari. Nga kjo pikëpamje pakica vlerëson se neni 5 i ligjit nr.9701, datë 2.4.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7843, datë 13.7.1994”, objekt kundërshtimi kushtetues, nuk bën gjë tjetër veçse rritet *parimin e prioritetit në kohë* ose të *përparësisë së pronësive të regjistruara*, të sanksionuar në nenin 10 të ligjit bazë.

Legjislatori, bazuar në fakte të shumta që tashmë janë pjesë e domenit publik të keqadministrimit të regjistrimit, duke pasur në konsideratë që mbajtja dhe administrimi i mirë i tij përmbush interesin më të lartë të publikut, bazuar në rregullimet e ligjit bazë të cilat përjashtojnë kategorikisht ekzistencën e mbivendosjeve, ka miratuar ligjin nr. 9701, datë 2.4.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7843, datë 13.7.1994”, në të cilin përfshihet edhe dispozita objekt kundërshtimi. Legjislatori e ka konsideruar të domosdoshme përfshirjen në këtë ligj të dispozitës objekt shqyrtimi, nisur edhe nga vlerësimi ligjor se ekzistenca e mbivendosjeve të titujve të regjistrimit të pronësisë që nuk rrjedhin nga njëri tjetri tregojnë qartësisht se regjistrimi i dytë nuk është regjistrim i plotë, i rregullt dhe ligjor. Megjithatë, në këtë ndërhyrje, legjislatori duke rritet *parimin e prioritetit në kohë* ose të *përparësisë së pronësive të regjistruara* i ka dhënë diskrecion regjistruesit dhe kryeregjistruesit vetëm për të vendosur *fshirjen* e regjistrimeve të kryera pas regjistrimit të parë, (kur i pari gjendet në përputhje me ligjin). Bazuar në dispozitën objekt kundërshtimi, pakica është e mendimit se fshirja e regjistrimit të dytë që nuk rrjedh nga i pari bëhet vetëm për faktin se është i dyti në radhë, sipas parimit të *prioritetit në kohë* dhe jo për faktin se titulli i regjistrimit të parë është i vlefshëm, ndërsa titulli i regjistrimit të dytë është i pavlefshëm. Duke qenë i dyti në radhë regjistrimi i këtij titulli nga këndvështrimi i thjeshtë i regjistrimit nuk është një regjistrim i plotë, i rregullt dhe ligjor. Bazuar në llojin dhe mjetin e ndërhyrjes si dhe në faktin se mbajtja dhe administrimi i regjistrimit përmbush interesin më të lartë të publikut, çmujmë se legjislatori në parashikimin e dispozitës, objekt kundërshtimi, është kushtëzuar vetëm nga situata objektive e mbivendosjes së titujve të regjistrimit të pronësisë që nuk rrjedhin nga njëri tjetri. Nga ana tjetër nuk vlerësojmë se ka ndërhyrje për të vendosur drejtësinë mbi titujt e regjistrimit të pronësisë së individëve, pasi kjo gjë do të cenonte jo vetëm parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, por

edhe thelbin e të drejtës së pronës së atyre, titulli i regjistrimit të të cilëve duhej fshirë. Përkundrazi këta individë bazuar në nenin 42 të Kushtetutës, dhe nenet 5 dhe 21 të ligjit nr.9701, datë 2.4.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 “ kanë të drejtë t’i drejtohen gjykatës në se çmojnë se e drejta e tyre e pronës është cenuar si nga akti administrativ i fshirjes, ashtu edhe nga pretendimi i qenies pronar i të tjerëve mbi pronën e tyre. Në këto raste zhvillohet një gjykim themeli mbi vlefshmërinë e titujve të pronësisë së tyre, çka garanton në këtë mënyrë parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, të drejtën e pronës dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor, sanksionuara nga nenet 7, 41 dhe 42 të Kushtetutës.

Pakica çmon se i pabazuar është edhe pretendimi i kërkuesit se dispozita e kundërshtuar cenon parimin e barazisë përpara ligjit, të sanksionuar nga neni 18 i Kushtetutës pasi, sipas kërkuesit, rregullimi i kundërshtuar veçon regjistrimet që nuk kanë rrjedhur nga njëri-tjetri (i fshin ato) dhe nuk rregullon të gjitha mbivendosjet. Gjykata Kushtetuese e ka shtjelluar këtë parim në disa prej vendimeve të saj (*shih vendimet nr.18, datë 29.07.2008, nr.33 datë 12.09.2007 dhe nr. 9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Kështu, Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.18 datë 29.07.2008 është shprehur se: “...barazia në ligj dhe para ligjit nuk parakupton zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme, por ajo parakupton kryesisht barazinë e individëve që ndodhen në kushte të njëllota”.

Legjislatori me anë të parashikimit të përfshirë në nenin 5 të ligjit nr.9701, datë 2.4.2007, objekt kundërshtimi kushtetues, duke marrë në konsideratë që mbajtja dhe administrimi i mirë i regjistrimit përmbush interesin më të lartë të publikut, ka synuar të eliminojë mbivendosjen e regjistrimeve që nuk rrjedhin nga njëri-tjetri, çka ezauron të gjitha rastet e mbivendosjeve, duke ritheksuar parimin e *prioritetit në kohë* dhe atë të vazhdimësisë së regjistrimeve të sanksionuara për herë të parë në ligjin bazë të regjistrimit. Pakica thekson se diferencimi i titujve të regjistrimeve të individëve të ndryshëm, i sanksionuar që në ligjin bazë, duke qenë se buron nga situata dhe kushte objektive, *prioritet në kohë dhe vazhdimësi regjistrimesh* e bën plotësisht të përligjur atë për shkak të qenies së individëve e të kategorisë së personave, në kushte objektivisht të ndryshme.

Pakica vlerëson se i pabazuar është edhe pretendimi i kërkuesit se udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 21.11.2007 “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” është antikushtetues, pasi cenon të drejtat e cituara më sipër. Gjyqtarët në pakicë arrijnë në këtë konkluzion jo vetëm se shkaqet që parashtron kërkuesi për antikushtetutshmërinë e këtij akti administrativ janë të njëjta me ato që ai ngre për antikushtetutshmërinë e nenit 5 të ligjit nr.9701, datë 2.4.2007, por edhe se Këshilli i Ministrave, në nxjerrjen e këtij akti, nuk rezulton të ketë shkelur kërkesat e nenit 118 të Kushtetutës. Përveç sa më sipër, në këtë akt, Këshilli i Ministrave duke u bazuar në parimet e *prioritetit në kohë* dhe të *vazhdimësisë së regjistrimeve* e duke vlerësuar që mbivendosja e regjistrimeve mund të ishte edhe pjesore ka parashikuar, që fshirja e regjistrimit të bëhet vetëm për pjesën e mbivendosur, ndërsa për pjesën tjetër, individit, të cilit regjistrimi i titullit i fshihet pjesërisht ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës. Këshilli i Ministrave, nisur nga parimet bazë të regjistrimit, të cituara më sipër, si dhe nga synimi i legjislatorit, ka parashikuar fshirjen pjesore vetëm si pasojë e situatës objektive të mbivendosjes së regjistrimeve që nuk rrjedhin nga njëri tjetri, por gjithmonë duke mos ndërhyrë për të vendosur drejtësinë mbi titujt e regjistrimit të pronësisë të individëve të ndryshëm. Në rastin e fshirjes pjesore të regjistrimit del dhe funksioni i regjistrimit si publikim njoftimi, pasi personit që i fshihet pjesërisht regjistrimi për shkak të mbivendosjes informohet dhe njoftohet nga zyra e regjistrimit, jo vetëm në lidhje me individin që duhet të padisë në gjykatë për shkak se prona e tij e regjistruar e para ka mbivendosje të pjesshme me pronën e tij, por edhe në lidhje me objektin e saktë të padisë që ka të bëjë me përcaktimin e pjesës që mbivendoset.

Në vlerësimin e pakicës është i pabazuar dhe pretendimi i kërkuesit për antikushtetutshmërinë e udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 31.01.2007 “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”. Meqenëse shumica e ka rrëzuar kërkesën për këtë akt, pakica i qëndron argumentit të pasqyruar në vendim.

Si përfundim, gjyqtarët në pakicë janë të mendimit se rrëzimi i kërkesës do të ishte zgjidhja më e drejtë për çështjen.

Anëtarë: Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Sokol Sadushi, Admir Thanza.

KËRKESË
Nr.2552, datë 28.4.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Në mbështetje të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë arë, truall dhe objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By Pass Plepa-Kavajë Rrogozhinë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 26 798 154 (njëzet e gjashtë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

Tabela e përgjithshme e objekteve për segmentin Plepa – Rrogozhinë
Loti 1, 2, 3, 4, 5

Nr.	Objekti	Pronari	Vlera (lekë)	Shënime
1	Karburant Eurodrin	Xhaferr & Agim Kraja	1847487	
2	Karburant Bovl-Oil	Beqir Llavanji	360349	
3	Karburant Alpet 1	Mustafa Koka	1855072	
4	Karburant Elda	Pilo Kerri	959699	
5	Karburant Alpet 2	K.Kristo, A.Dimo	984474	
6	Karburant Klevi	Gramoz Manaj	1090300	
7	Hotel Skampa	Agim Sula	3002120	
8	Karburant ne ndertim	Besnik Hasa	616502	
	SHUMA		10716003	

MPPT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA SHPRONËSIMEVE

Lista e pasurive që shpronësohen nga ndërtimi i By-Pass "Plepa-Kavajë-Rrogozhinë"
 Loti 1,2,3,4,5

Nr.	Pronari			Zona kad.	Nr /pas	Sip. m ²	Lloji Pasurisë	Çmimi	Vlera	Loti	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
2	I paidentifikuar			8518	58/100	48	truall	20167	968016	pretendon Bp/Morina	Publikim
3	I paidentifikuar			8518	59/20	24			0	Loti 1,2	Publikim
4	Ramadan		Toska	8518	59/33	71	truall	20167	1431857	Loti 1,2	Publikim
5	Beniamin		Kapllani	8518	59/86	393	truall	20167	7925631	Loti 1,2	Publikim
6	Beniamin		Kapllani	8518	59/98	26	truall	20167	524342	Loti 1,2	Publikim
7	Galip		Gjuzi	2291	373/2	81	are	554	44874	Loti 3	Publikim
8	Ymer		Lushakaj	2291	373/50	78	are	554	43212	Loti 3	Publikim
9	Astrit		Ismaili	2291	373/51	42	are	554	23268	Loti 3	Publikim
10	Astrit		Ismaili	2291	373/44	10	are	554	5540	Loti 3	Publikim
11	Arben		Burimi	2291	373/48	330	are	554	182820	Loti 3	Publikim
12	Çlirim		Beu	2291	373/55	58	are	554	32132	Loti 3	Publikim
13	B/pr Sabri		Dedej	2291	373/57	226	are	554	125204	Loti 3	Publikim
14	Idriz		Dervishi	2291	104/27	537	are	554	297498	Loti 3	Publikim
15	Durim		Dervishi	2291	104/28	323	are	554	178942	Loti 3	Publikim
16	Hasan		Sulejmani	2291	104/81	260	truall	1257	326820	Loti 3	Publikim
17	Agim		Sula	2291	104/71	150	are	554	83100	Loti 3	Publikim
18	Agim		Sula	2291	104/92	125	are	554	69250	Loti 3	Publikim
19	Illir		Rama	2291	104/61	55	are	554	30470	Loti 3	Publikim
20	Illir		Rama	2291	104/58	50	are	554	27700	Loti 3	Publikim
21	Kostandin		Risto	2291	104/127	300	truall	1257	377100	Loti 3	Publikim
22	Nefije		Bardhi	2291	104/83	129	truall	1257	162153	Loti 3	Publikim
23	Qerim		Dervishi	2291	104/64	115	are	554	63710	Loti 3	Publikim
24	Shyqyri		Dervishi	2291	104/84	23	are	554	12742	Loti 3	Publikim
25	Myslym		Kuka	2291	104/65	21	are	554	11634	Loti 3	Publikim
26	Vasil		Papa	2291	104/76	8	are	554	4432	Loti 3	Publikim
27	Qerim		Dervishi	2291	104/129	10	are	554	5540	Loti 3	Publikim

28	Islam		Lika	2291	104/133	58	are	554	32132	Loti 3	Publikim
29	Namire		Gjuzi	2291	104/136	18	are	554	9972	Loti 3	Publikim
30	Behar		Male	2291	116/36	104	are	554	57616	Loti 3	Publikim
31	Tid SHpk B/pronare			2291	116/21	136	truall	1257	170952	Loti 3	Publikim
32	Tid SHpk B/pronare			2291	116/38	144	truall	1257	181008	Loti 3	Publikim
33	Muharrem		Lutvija	2291	117/34	47	are	554	26038	Loti 3	Publikim
34	Besim		Istrefi	2291	117/73	19	are	554	10526	Loti 3	Publikim
35	Muharrem		Gjuzi	2291	117/61	56	truall	1257	70392	Loti 3	Publikim
36	Durim		Gjuzi	2291	117/58	175	are	554	96950	Loti 3	Publikim
37	Bashkim		Koka	2291	117/2	85	are	554	47090	Loti 3	Publikim
38	Halil		Koka	2291	117/23	73	are	554	40442	Loti 3	Publikim
39	Gani		Koka	2291	117/30	265	are	554	146810	Loti 3	Publikim
40	B/p Gani		Hoxha	2291	122/104	296	are	554	163984	Loti 3	Publikim
41	Agim		Hoxha	2291	122/88	190	are	554	105260	Loti 3	Publikim
42	Rifat		Hoxha	2291	122/76	177	are	554	98058	Loti 3	Publikim
43	Haxhi		Estrefi	2291	122/94	24	are	554	13296	Loti 3	Publikim
44	Erbert		Bodlli	2291	308/113	30	are	554	16620	loti 4,5	Publikim
45	Ndricim		Bodlli	2291	308/115	31	are	554	17174	loti 4,5	Publikim
46	Zyber		Bodlli	2291	308/110	34	are	554	18836	loti 4,5	Publikim
47	Azem		Troplini	2291	308/33	100	are	554	55400	loti 4,5	Publikim
48	Fadil		Troplini	2291	308/50	61	are	554	33794	loti 4,5	Publikim
49	Fatmir		Troplini	2291	308/6	18	are	554	9972	loti 4,5	Publikim
50	Gani		Troplini	2291	308/5	51	are	554	28254	loti 4,5	Publikim
51	Braim		Cela	2291	308/105	63	are	554	34902	loti 4,5	Publikim
52	Braim		Cela	2291	308/108	50	are	554	27700	loti 4,5	Publikim
53	Telha		Greca	2291	308/60	34	are	554	18836	loti 4,5	Publikim
54	Isa		Hoxha	2291	357/101	25	are	554	13850	loti 4,5	Publikim
55	Illir		Mecja	2291	357/117	40	are	554	22160	loti 4,5	Publikim
56	Kimete		Mecja	2291	357/123	50	are	554	27700	loti 4,5	Publikim
57	Arjan		Sejdani	2291	357/121	23	are	554	12742	loti 4,5	Publikim
58	Illir		Mecja	2291	357/119	85	are	554	47090	loti 4,5	Publikim
59	Ahmet		Habili	1791	71/49	48	are	340	16320	loti 4,5	Publikim
60	Violeta		Agalliu	1791	71/50	27	are	340	9180	loti 4,5	Publikim
61	Sadullame		Habili	1791	71/51	30	are	340	10200	loti 4,5	Publikim
62	Artan		Habili	1791	71/52	21	are	340	7140	loti 4,5	Publikim
63	Batran		Habili	1791	71/53	23	are	340	7820	loti 4,5	Publikim

64	Lulzim		Habili	1791	71/54	51	are	340	17340	loti 4,5	Publikim
65	Sulce		Licaj	1791	89/80	247	are	340	83980	loti 4,5	Publikim
66	B/Pr Halilaj			1791	71/55-71-59	63	are	340	21420	loti 4,5	Publikim
67	Ibrahim		Agalliu	1791	89/18	56	are	340	19040	loti 4,5	Publikim
68	Xheladin		Dedej	1791	89/73	48	are	340	16320	loti 4,5	Publikim
69	Xheladin		Dedej	1791	89/76	51	are	340	17340	loti 4,5	Publikim
70	Jonulla		Estrefi	1791	89/74	51	are	340	17340	loti 4,5	Publikim
71	Sade		Ducollari	1791	89/77	45	are	340	15300	loti 4,5	Publikim
72	Fatbardh		Muho	1791	89/79	94	are	340	31960	loti 4,5	Publikim
73	Xhevdet		Plaku	1791	89/82	145	are	340	49300	loti 4,5	Publikim
74	Dhoksi		Caci	1791	89/36	35	are	340	11900	loti 4,5	Publikim
75	Fatbardha		Renja	1791	89/84	46	are	340	15640	loti 4,5	Publikim
76	Fatbardha		Renja	1791	89/85	32	are	340	10880	loti 4,5	Publikim
77	Hazbi		Haka	1791	89/87	65	are	340	22100	loti 4,5	Publikim
78	I pidentifikuar			1791	89/61	16	are	340	5440	loti 4,5	Publikim
79	Figiri		Xherri	1791	89/63	72	are	340	24480	loti 4,5	Publikim
80	Resmi		Kondi	1791	89/64	64	are	340	21760	loti 4,5	Publikim
81	Ali		Kercova	1791	110/193	58	are	340	19720	loti 4,5	Publikim
82	Ismail		Kraishta	1791	110/195	30	are	340	10200	loti 4,5	Publikim
83	Teki		Kala	1791	110/27	32	are	340	10880	loti 4,5	Publikim
84	Ali		Kalo	1791	110/28	44	are	340	14960	loti 4,5	Publikim
85	Shpresa		Kala	1791	110/29	42	are	340	14280	loti 4,5	Publikim
86	B/pronare Licaj			1791	110/30	76	are	340	25840	loti 4,5	Publikim
87	Sulce		Licaj	1791	110/31	43	are	340	14620	loti 4,5	Publikim
88	Hekuran		Selimi	1791	110/32	62	are	340	21080	loti 4,5	Publikim
89	Gentian		Kamara	1791	110/33	59	are	340	20060	loti 4,5	Publikim
90	Bardhyl		Karaj	1791	110/34	20	are	340	6800	loti 4,5	Publikim
91	Bardhyl		Karaj	1791	110/35	27	are	340	9180	loti 4,5	Publikim
92	Sherbet		Copa	1791	110/36	85	are	340	28900	loti 4,5	Publikim
93	Rrahim		Alabaku	1791	110/37	48	are	340	16320	loti 4,5	Publikim
94	Qazim		Alabaku	1791	110/38	92	are	340	31280	loti 4,5	Publikim
95	Ibrahim		Berisha	1791	110/39	63	are	340	21420	loti 4,5	Publikim
96	Edmond		Merhori	1791	110/40	28	are	340	9520	loti 4,5	Publikim
97	Zyber		Dedja	1791	110/41	37	are	340	12580	loti 4,5	Publikim
98	Xheladin		Metani	1791	110/42	34	are	340	11560	loti 4,5	Publikim
99	Zyber		Dedja	1791	110/43	32	are	340	10880	loti 4,5	Publikim

100	Xheladin		Metani	1791	110/44	31	are	340	10540	loti 4,5	Publikim
101	B/pronare Godo			1791	110/88	118	are	340	40120	loti 4,5	Publikim
102	Ymer		Metani	1791	110/49	35	are	340	11900	loti 4,5	Publikim
103	Luan		Jaho	1791	110/64	49	are	340	16660	loti 4,5	Publikim
104	Faik		Copani	1791	110/67	42	are	340	14280	loti 4,5	Publikim
105	B/pr Sul		Hidri	1791	132/73	25	are	340	8500	loti 4,5	Publikim
106	Sulejman		Hidri	1791	132/78	83	are	340	28220	loti 4,5	Publikim
107	Sul		Hidri	1791	132/63	18	are	340	6120	loti 4,5	Publikim
108	I pidentifikuar			1791	132/56	19			0	loti 4,5	Publikim
109	I pidentifikuar			1791	132/59	125			0	loti 4,5	Publikim
110	Trifon		Illiu	1791	132/143	27	are	340	9180	loti 4,5	Publikim
111	Bolv Oil SHA			1791	132/144	86	are	340	29240	loti 4,5	Publikim
112	Bolv Oil SHA			1791	132/79	6	are	340	2040	loti 4,5	Publikim
113	Bolv Oil SHA			1791	132/80	327	are	340	111180	loti 4,5	Publikim
114	Vergjeni		Barko	1791	132/25	7	are	340	2380	loti 4,6	Publikim
115	Sami		Sheme	1791	132/95	84	are	340	28560	loti 4,5	Publikim
116	Sami		Sheme	1791	132/40	84	are	340	28560	loti 4,5	Publikim
117	I pidentifikuar			3101	35/27	46			0	loti 4,5	Publikim
118	Hasan		Krasniqi	3101	35/80	169	are	336	56784	loti 4,5	Publikim
119	Lefter		Tafa	3101	35/79	90	are	336	30240	loti 4,5	Publikim
120	Imer		Lusha	3101	35/66	92	are	336	30912	loti 4,5	Publikim
121	Fatmir		Shala	3101	35/29	118	are	336	39648	loti 4,5	Publikim
122	Ymer		Shala	3101	35/81	208	are	336	69888	loti 4,5	Publikim
123	Iilir		Merhori	3101	90/45	50	are	336	16800	loti 4,5	Publikim
124	Iilir		Merhori	3101	90/8	13	are	336	4368	loti 4,5	Publikim
125	Besnik		Hasa	3101	90/9	63	are	336	21168	loti 4,5	Publikim
126	Zamake		Hasa	3101	90/12	71	are	336	23856	loti 4,5	Publikim
127	Shpetim		Gjuzi	3101	90/42	76	are	336	25536	loti 4,5	Publikim
128	Bore		Vila	3101	90/14	55	are	336	18480	loti 4,5	Publikim
129	Rifat		Hasa	3101	90/10	63	are	336	21168	loti 4,5	Publikim
	SHUMA					10577			16082151		

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 11.5.2010

Doli nga shtypi më 13.5.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 44 lekë